

PROGRAMI PËR DECENTRALIZIM DHE ZHVILLIM LOKAL NË RAJONIN E LEZHËS DHE TË SHKODRËS

**Vlerësim Tematik
i Mbështetjes në hartimin e Paketës Fiskale të NjQV-ve**

**Antonin Braho
Dhjetor 2013-Shkurt 2014**



Përmbajtja

Faqe

PËRMBLEDHJE	1
1 KONTEKSTI I DLDP-SË	5
1.1 Mjedisi Ekonomik	5
1.2 Mjedisi Politik	6
1.3 Decentralizimi, gjendja aktuale	7
1.4 Dldp, vështrim i përgjithshëm	9
1.5 Një Vështrim mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Rishikimit të Fundit të Programit.....	10
2 OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TEMATIK	12
2.1 Qëllimi i këtij ushtrimi	12
2.2 Një vështrim mbi fushat e vlerësuara të projektit dhe indikatorët	13
2.2.1 Vërejtje te përgjithshme lidhur me situatën aktuale në qeverisjen lokale dhe dldp-në.....	13
2.2.2 Lista e Indikatoreve, metodologjia e perdorur per vleresimin dhe domethenia.	13
3 SHQYRTIMI I DETAJUAR DHE GJETJET KRYESORE	15
3.1 Shqyrtimi i Detajuar	15
3.1.1 Pershtatshmeria me kerkesat ligjore.....	15
3.1.2 Besueshmeria	15
3.1.3 Arritshmeria.....	18
3.1.4 Barazia	19
3.1.5 Transparenca dhe Pergjegjshmeria.....	19
3.1.6 Pjesmarrja dhe Motivimi.....	20
3.1.7 Sinergjia dhe Lidhshmeria	22
3.1.8 Indikoret e ndryshimit global	22
3.2 Shqyrtimi i Impaktit të Programit	24
3.3 Shqyrtimi në tërësi i indikatorëve – Përmbledhje e Gjetjeve	24
3.4 Mësimet e Nxjerra ne Tërësi	25
4 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	26
4.1 Konkluzione.....	26
4.2 Rekomandime	26
5 ANEKSE	27

SHPJEGIME NE SHKURTIMET

BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botwrore
BERZH	Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
MF	Ministria e Financave
IPF	Instrumenti i Planifikimit Financiar
NJMP	Njësia e Manaxhimit të Programit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat Njerëzore
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PBA	Plani Afatmesëm Buxhetor
PCM	Cikli i Manaxhimit të Projekteve
PD	Partia Demokratike
PEFA	Vlerësim i Kuadrit të Shpenzimeve Publike
PO	Përgjegjës Projekti
PPB	Produkti i Përgjithshëm Bruto
PS	Partia Socialiste
PSZH	Planet Strategjike te Zhvillimit
QSH	Qeveria Shqiptare
SDC	Swiss Agency for Development and Cooperation
TAP	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
TBV	Taksa mbi Biznesin e Vogël
TF	Tatim Fitim
TVSH	Taksa mbi Vlerën e Shtuar

PËRMBLEDHJE

Programi dhe Marrëveshja e Financimit

Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp) filloi fazën e dytë të tij në mars 2010 dhe zgjati deri në shkurt 2013. Shtrirja gjeografike e programit mbulon 33 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) në Qarkun e Shkodrës dhe 21 në atë të Lezhës. Popullsia totale në rajon arrin në 554000 banorë, nga të cilët 40 % jetojnë në zona urbane dhe përafërsisht 30 % jetojnë në nivelin e varfërisë (sipas vlerësimeve zyrtare ne 2004).

Qëllimi kryesor i dldp-së është: *të rrisë kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore në Shkodër dhe Lezhë në mënyrë që të kontribuohet në zhvillimin rajonal në Shqipërinë Veriore dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar.*

Agjencia donatore	Agjencia Zvicerane për Zhvillimin dhe Bashkëpunim(SDC) Divizioni i Ballkanit Perëndimor Freiburgstrasse 130 3003 Bernë Zvicër Tel. +41 31 322 44 05, Fax +41 31 323 59 33 SDC/SECO Zyra e Agjencisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim c/o Ambasada e Zvicrës Rruga Brigada e VIII P2/2/1 Tirana Shqipëri Tel. +355 4 240 102, Fax +355 4 240 103
Agjencia Zbatuese	Helvetas Swiss Intercooperation Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Maulbeerstrasse 10 P.O. Box 6724 3001 Berne Zvicër T +41 31 385 10 10 F +41 31 385 10 09 www.helvetas.org Helvetas Swiss Intercooperation ne Shqiperi L. Kongresi Përmetit Rruga Oso Kuka Nr.11 Shkdora, Shqiperi T/F: +355 22 50 999 / 50 247
Numri i Programit SDC	Nr i Referencës 7F-04382.02
Partnerët Kryesorë	Njësit e pushtetit lokal (bashki dhe komuna) rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës, Shqipëria Veriore, Shoqata e Bashkive dhe Komunave, Ministria e Brendshme.
Kohëzgjatja e Fazës Marrëveshja për kuadrin ligjor të kontratës	Mars 2010 – Dhjetor 2013 Marrëveshja bilaterale midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Zvicrës, Marrëveshja e Projektit me Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë.
Kontrata e Projektit	Mbajtës i kontratës është Helvetas Swiss Intercooperation i mandatuar nga SDC

Konteksti

Ekonomia: Indikatorët e përgjithshëm makroekonomikë dëshmojnë që ekonomia shqiptare është duke përparuar në procesin e ndryshimit dhe transformimit nga një ekonomi e një vendi në zhvillim, ku burimet kryesore të rritjes ekonomike janë aktivitetet ekonomike që kanë të bëjnë me nxjerrjen dhe eksportin e lëndëve të para dhe minerare, drejt një ekonomie më dinamike ku vlera e shtuar në ekonomi vjen kryesisht nga aktivitetet e prodhimit dhe shërbimit. Megjithatë, në kushtet e tregjeve të paqëndrueshme financiare globale si pasojë e niveleve të larta të borxhit publik në eurozonë dhe situatës shqetësuese ekonomike në Greqi dhe Itali, rruga e

mëtejshme e zhvillimit ekonomik në Shqipëri mund të ndikohet nga rreziqet e lidhura me zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale për arsye të ekspozimit të lartë që ka Bilanci i Pagesave të vendit ndaj këtyre ekonomike si pasojë e Bilancit Tregtar dhe Transfertave të emigrantëve dhe diasporës shqiptare që jeton në këto vende. Këto rreziqe duket se janë materializuar në 2013 ku ritmet e rritjes së PPB janë ulur përtej niveleve të parashikuara nga MF. Borxhi publik është rritur duke arritur nivele të tilla, të cilat nëse do të mbeten jashtë vëmendjes, do të kërcënojnë stabilitetin makroekonomik të vendit. Në mënyrë që të përballohen këto rreziqe, QSH është në procesin e miratimit të një pakete të re fiskale, e cila do të bëjë kalimin nga sistemi i taksimit të sheshtë në atë progresiv.

Politika:

Situata politike gjatë periudhës 2009-2012, e cila korrespondon me fazën I dhe II të zgjatjes së *dldp-së*, pavarësisht se e qëndrueshme, është acaruar disa herë për shkak të diskutimeve midis aktorëve kryesore politike. Procesi i aderimit në Bashkimin Evropian (BE) ka përparuar në mënyrë të ngadalshme; në dhjetor 2012, Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian vendosën që t'i japin Shqipërisë statusin kandidat sapo të arrihet një progres i nevojshëm në fusha të caktuara dhe më konkretisht në fushën e gjyqësorit, të administratës publike dhe të procedurave parlamentare. Zgjedhjet e reja të përgjithshme parlamentare të programuara për tu mbajtur në qershor 2013, u konsideruan të drejta dhe në përputhje me standartet demokratike. Tranzicioni i pushtetit në duart e koalicionit të ri fitues u bë në mënyrë të butë dhe të qetë, duke rritur kështu shpresat e shqipëtarëve për të marrë statusin e vendit kandidat për në BE. Megjithatë, në dhjetor 2013, pas një votimi parlamentar në Hollandë dhe votimit në Këshillin Europian të disa nga ministrave të jashtëm të vendeve anëtarë të BE (Gjermania, Franca, Anglia, Danimarka), u vendos që vendimi për statusin e Shqipërisë si vend kandidat të shtyhet për në qershor 2014, me kusht që Shqipëria të mbetet e angazhuar në rrugën e reformave të mëtejshme për luftën kundër korrupsionit dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Decentralizimi:

Pavarësisht se reforma e decentralizimit është angazhim, shpejtësia e zbatimit të saj mbetet ende e ngadaltë. Ligji i financave lokale i projektuar që në vitin 2008 nuk është miratuar dhe zbatuar ende dhe sot e kësaj dite. Decentralizimi fiskal është ende në fazën fillestare dhe burimi i vetëm domethënës i të ardhurave, i kaluar nga qeveria qendrore qeverisë lokale është Taksa e Biznesit të Vogël (TBV); të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë janë ende modeste për të siguruar burime të mjaftueshme për NJQV-në. Ka një konsensus në rritje për t'i transferuar më tepër burime të ardhurash pushtetit lokal nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në taksat kombëtare (si direkte dhe jodirekte); megjithatë, ende nuk ka vendime përfundimtare në këtë drejtim. Shpjegimi më i arsyeshëm për drujtjen që të përparohet në këtë drejtim ka të bëjë me përgjegjësitë e sigurimit të shërbimeve parësore publike sociale të popullatës, të cilat bien mbi qeverinë qendrore. Për më tepër, tipologjia e qeverisjes lokale në Shqipëri karakterizohet nga ekzistenca e shumë NJQV-ve të vogla, aftësia e të cilave për të ofruar shërbime publike në mënyrë efektive dhe efikente mbetet e kufizuar- në vetvete kjo tregon nevojën e konsensusit politik për reforme në këtë drejtim. Më në fund me parlamentin e ri ka një angazhim konkret në lidhje me këtë reformë, e cila shpresohet që mund të përfundojë në gjysmën e parë të 2014 – afat, i cili duket tepër optimist kur dihen interesat e mëdha politike në lidhje me reformën në fjalë. Ndërsa huamarrja mbetet një pamundësi praktike për shkak të masës së madhe që zë borxhi i qeverisë qendrore në borxhin publik, burimet kryesore të të ardhurave për NJQV-të mbeten transfertat buxhetore qeveritare, pjesa e kushtëzuar e të cilave gjatë periudhës së punës së *dldp-së* ka ardhur në rritje në dëm të transfertave të pakushtëzuara, të cilat në rastin më të mirë kanë mbetur në nivele konstante. Në linjë me Kartën Europiane të Autonomisë së Qeverisjes Vendore, ky realitet është ndoshtë një nga faktet më të qarta që tregon se Shqipëria ka ende një rrugë të gjatë përpara për të arritur në një sistem të qeverisjes vendore efektiv dhe autonom- në vetevete kjo rrugë përfaqson një sfidë në rrugën e integritetit evropian të vendit

Vlerësimi i Përgjithshëm i Programit dhe disa gjetje

Ky raport është rezultati i një vlerësimi tematik, prandaj vlerësimi i ndikimeve të til duhet konsideruar vetëm në lidhje me një komponent të programit, atë të mbështetjes së paketës fiskale. Ndikimi i programit përse i përket aspekteve të tjera të mbështetur nga programi si Planifikimi Strategjik dhe Planifikimi Buxhetor Afatmesëm (PSZH/PBA), mund të konsiderohet vetëm për aq sa mbështetja e paketës fiskale ka patur ndikim në indikatorët respektivë që shërbejnë për të monitoruar këto aspekte të cilat këtu janë referuar si indikatorë globalë të ndryshimit. Metodologjia e vlerësimit kombinon rishikimin e dokumenteve dhe studimeve të prodhuara gjatë programit dhe intervista dhe anketa mbi pyetësorë me përfituesit e projektit.

Programi dldp filloi në një periudhë rritjeje me norma të larta rritjeje, i cili influenoi në projekt programin me aktivite të fokusuar në shumë aspekte të planifikimit strategjik dhe të sistemit të financave publike lokale të lidhura me të. Megjithatë, fakti që programi ka gjetur menyren për të futur një tjetër komponent për të mbështetur ndërkohë që situata e përgjithshme në vënd është bërë më e vështirë, tregon aftësi për t'iu përshtatur evoluimit të situatës edhe në kohë të vështira me shtrëngesa buxhetore.

Rezultatet e mira në komponentet PSZH/PBA, gjithmonë në terma të etapave të planifikimit/formulimit të buxhetit, janë përforcuar edhe më tej si pasojë e futjes së komponentit të paketës fiskale. Ky përfundim do të ndikojë cilësinë e shërbimeve të ofruara në të ardhmen popullatës në NJQV respektive sepse futja e paketës fiskale ka sjellë një përmirsim në PSZH dhe PBA në aspektin metodologjik dhe në atë të cilësise.

Vihet re po ashtu dhe një përmirësim në lidhje me parashikueshmërinë e fondve NJQV në të ardhmen; indikator i që monitoron këtë dimension të financave lokal tregon një përmirsim të mëtijshëm me futjen e komponentit të paketës fiskale. Pa dyshim që futja e këtij komponenti i ka dhënë zyrtarëve lokalë një instrument për të punuar në dy fronte: parashikueshmërinë dhe transparencën. Ndërsa ne parashikueshmëri ndikimi ka qënë pozitiv, ndikimi në transparencë ka qënë pozitiv vetëm në më pak se gjysmen e NJQV të asistuar, gjë që justifikohet nga koha relativisht e shkurtër (1 vit) e mbështetjes së paketës fiskale. Gjithësesi, dldp ka mundësinë të përmirsojë rezultatet edhe në lidhje me transparencën duke bashkrenduar procedurat dhe praktikën e PF me ato të komponentëve të tjerë të programit PSZH/PBA ku indikatorët e transparencës janë në nivele mjaft të mira.

Ka po ashtu një impakt të gjerë të programit veçanërisht në sasinë dhe cilësinë e PSZH-ve të prodhuara dhe koordinimin e tyre me PBA, nëpërmjet një standarti si FP dhe instrumentit të planifikimit financiar (IPF). FP janë mjaft mirë në aspektin e cilësisë së paraqitjes, domethënies dhe qartësisë së informacionit.

Me poshtë po paraqesim më në detaje disa nga gjetjet e këtij vlerësimi:

Aktualisht, në kontekstin e uljes së ritmeve të rritjes ekonomike, mjedisi i përgjithshëm në Shqipëri për zhvillimin e trajtimeve strategjike në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel lokal është sfidues. Si i tillë ai ka të bëjë me burime financiare të kufizuara në dispozicion të NJQV si rezultat i transfertave më të ulëta nga qeverisja qendrore në formën e transfertave të pakushtëzuara dhe të ardhurave lokale modeste.

Paketat fiskale janë miratuar *de facto* me shumicë të votave pavarësisht se ligji kërkon miratim me shumicë të thjeshtë. Ky rezultat i ka bërë praktikisht këto paketa ligjore gjithëpërfshirëse për të gjithë interesat politike.

Regjistrat e taksave duket se ekzistojnë në shumicën e NJQV të mbështetura nga dldp-ja, gjë që ka të bëjë me faktin e përgjegjësisë së administratës vendore për të mbledhur taksën e biznesit të vogël (TBV) që prej 2008. Gjithësesi, ato nuk janë të mjaftueshme ose nuk janë përdorur mjaftueshëm për parashikime fiskale statistikore të arsyeshme ose të mira.

Ka fakte që tregojnë se potenciali për parashikime statistikore fiskale nuk është shfrytëzuar në ato NJQV ku ka të dhëna të mjaftueshme- gjë që tregon për mungesë kapacitetesh ose mjetesh për të realizuar këto parashikime. Cfarë është më e rëndësishme, është se ekziston një perceptim i përgjithshëm se kjo mënyrë e të vepruarit është e mjaftueshme.

Vihet re një tendencë e rritjes së numrit të tarifave në krahasim me taksat vendore që tregon një tendencë lëvizje drejt ofrimit të shërbimeve nga ana zyrtarëve publikë lokalë. Ngarkesa e punës e këtyre

zyrtarëve ne lidhje me taksat dhe tarifat vendore mbetet e lartë dhe në mënyrë që të përballohet shumica e NJQV kanë zgjedhur alternativën e rritjes së numrit të zyrtarëve publikë lokalë.

Megjithatë vërehet se ka NJQV të cilat janë përpjekur të rrisin efektivitetin e punës së zyrtarëve publikë tatimorë lokalë duke investuar në programe kompjuterike, trainime, shkëmbim informacioni me zyrat tatimore rajonale etj.

Barazia horizontale është e pranishme gjerësisht në të gjitha taksat dhe tarifat, por barazia vertikale është po ashtu e pranishme.

Informacioni për taksat/tarifat me udhëzime të qarta dhe penalitetet dhe shkalla e pjesmarrjes në procesin e hartimit të PF nuk është në nivele të kënaqshme për arsye të mosperdorimit të kanaleve efektive të komunikimit.

PF janë shumë të qarta, në linjë me PBA dhe parashikimet makroekonomike ne nivel lokal dhe rajonal.

Dldp ka arritur të ruajë orientimin strategjik dhe atij të fokusuar në politikat në procesin e buxhetimit; për më tepër programi ka arritur të përmirsojë rezultatet në këtë drejtim edhe përgjatë 2013 pavarësisht shtrëngesave buxhetore.

Parashikueshmëria e buxheteve lokale është përmirësuar edhe më tepër me shmangiet midis PBA-ve dhe planeve vjetore buxhetore më të ulëta gjatë 2013.

Rekomandime

Në lidhje me kredibilitetin e PF ka një nevojë urgjente për identifikimin dhe shkëmbim informacioni me autoritetet kombëtare dhe rajonale në mënyrë që të transformohen të dhënat e përditësuar nga regjistrat kombëtarë (regjistri civil, kadastrat, rrugët etj) dhe të popullohen bazat e të dhënave lokale. Dldp mund ta lehtësojë këtë proces brenda mandatit të programit duke përdorur reformën e re territoriale dhe administrative si një mundësi për të rritur interesimin/ndërgjegjësimin e autoriteteve publike.

Dldp duhet të rrisë ndërgjegjshmërinë dhe vetëdijen e zyrtarëve publikë për përfitimet nga analizat e detajuara statistikore si një mënyrë për të rritur realizmin e parashikimeve ardhurave fiskale lokale; dldp ka eksperiencën e duhur për të ndikuar dhe qënë efektive në këtë drejtim.

Ne lidhje me konsideratat e barazisë në paketat fiskale, dldp nuk ka mandat për të hyrë në diskutime politike për aspekte të barazisë horizontale apo vertikale në taksa apo tarifat vendore. Megjithatë ka vënd për të kontribuar, për sa i përket argumentave teorike, të dhënave reale dhe praktike në mënyrë që të shmangët retorika e panevojshme politike. Këtu, është e nevojshme që dldp të vazhdojë me aktivitetet e rritjes së kapaciteteve në veçanti me MPF, i cili, së bashku me PF, mund të ofrojë skenarë të ndryshëm, nisur nga supozime të ndryshme që mund të përfshijnë edhe konsiderata të barazisë horizontale apo vertikale në propozimet fiskale.

Për sa i përket transparencës/përgjegjshmërisë dhe pjesmarrjes/motivimit, rekomandohet që dldp të përdorë mundësinë e harmonizimit të stimujve të NJQV nëpërmjet përhapjes së praktikave të mira të zhvilluara në komponentë të tjerë të programit, sidomos të atyre ky kanale komunikimi efektive kanë mundësinë e të arriturit të një numri maksimal të qytetarëve.

Dldp mund të vazhdojë të ndajë eksperiencat/ekspertizën, praktikat e mira si një qëndër ekselence dhe të përdorë këtë mundësi për të vënë në pah profilin/rolin e programit gjatë reformës së re administrative/territoriale.

Konkluzione

Ky raport arrin ne konkluzionin qe futja PF gjatë vitit 2013 ka qënë një gjetje e duhur dhe plotësisht e justifikuar në terma të ndikimit të përgjithshëm në paketën e përgjithshme të mbështetjes (PSZH/PBA) së NJQV nga dldp-ja për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe parashikueshmërinë e buxheteve vjetore dhe afatmesme. Ky produkt ka mundsinë të sjellë përfundime pozitive dhe përmirësime thelbësore në aspektin e transparencës nëse bashkëndehet me praktikat e mira, eksperiencën/ekspertizën e programit në fushat e tjera ku programi dldp siguron asistencë.

1 KONTEKSTI I DLDP-SË

Seksionet e mëposhtme japin një skicë të shkurtër të situatës ekonomike, politike dhe të decentralizimit aktualisht dhe në të ardhmen e afert, duke theksuar ato aspekte që janë menduar si më domethënëset për detyrën e këtij ushtrimi, me saktësi: vlerësimin tematik të fazës 2 të dldp në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës në lidhje me komponentin e paketës fiskale.

1.1 Mjedis i Ekonomik

Në vitin 1991, Shqipëria ishte një nga ekonomitë më pak të zhvilluara post-komuniste në Evropë. Produkti i Përgjithshëm Bruto (PPB) ra me mbi 30% në dy vitet e para të tranzicionit në ekonominë e tregut (1991-1992); rritja ekonomike rifilloi fuqishëm me vonë dhe vazhdoi me ritme të larta deri në 2009. Për rrjedhojë varferia ul dhe në vitin 2010, Produkti i Përgjithshëm Neto për kapitall ishte në nivelin e 3,980\$¹.

Në kontrast me shumë vende të tjera Evropiane, Shqipëria i kaloi valet e para të krizës financiare globale të 2009 mirë dhe arriti të shmangte një kontraktim të prodhimit. Edhe pse në dukje me rezistente ndaj shokut ekonomik të ekonomitë e tjera në rajon, ekonomia e Shqipërisë gjithsesi u ndikua nga kriza ekonomike botërore duke patur si pasojë uljen e shpejtësisë së rritjes ekonomike pas vitit 2009. Rritja e ulët ekonomike u theksuan më tej gjatë vitit 2013, ku ritmet e rritjes për tremujorin e tretë duken se janë më pak se 1.3%². Ndërsa në tremujorin e parë dhe të dytë, sektorët kryesorë me kontribut në rritjen ekonomike qenë sektori i shërbimeve dhe ai i ndërtimit, si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme të sektorit publik, pas zgjedhjeve elektorale të qershorit 2013, sektorët e vetëm me rritje ekonomike është sektori i prodhimit dhe ai i industrisë nxjerrëse. Kjo dinamikë e re e rritjes ekonomike është vjen kryesisht prej ndryshimit të mjedisit ekonomik ku kërkesa e jashtme është duke e marrë veten si pasojë e rritjes ekonomike në zonën e euros (ritme pozitive rritje vërehet në Francë dhe Gjermani, shenja të gjallërimit ekonomik në Itali, Spanjë dhe me gjasë fundi i krizës në Greqi).

Te dhenat e fundit nga Banka Qendrore e Shqipërisë, Ministria e Financave (MF) dhe Fondi Monetar Nderkombëtar (Aneksi 4) tregojnë që ekonomia shqiptare është duke avancuar në procesin e transformimit nga një ekonomi e një vendi në zhvillim, ku burimet kryesore të rritjes janë aktivitetet ekonomike të shërbimeve me nxjerrjen dhe eksportin e lendeve të para dhe materiale, në një ekonomi me dinamike ku vlera e shtuar vjen kryesisht nga aktivitetet e prodhimit dhe shërbimit. Megjithatë, në kushtet e tregjeve të paqëndrueshme financiare globale si pasojë e niveleve të larta të borxhit publik në eurozonë dhe situatës shqetësuese ekonomike në Greqi dhe Itali, rruga e metejshme e zhvillimit ekonomik në Shqipëri mund të ndikohet nga rreziqet e lidhura me zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale për arsye të ekspozimit të lartë që ka Bilanci i Pagesave të vendit ndaj këtyre ekonomive si pasojë e Bilancit Tregtar dhe Transfertave të emigrantëve dhe diasporës shqiptare që jetojnë në këto vende.

Në të kaluarën Qeveria Shqiptare (QSH) ka reaguar me kujdes ndaj rreziqeve dhe goditjeve të jashtme ekonomike. Përsa i përket financave qeveritare, te dhenat tregojnë se pavarësisht rritjes së deficitit fiskal para vitit 2009 për shkak të shpenzimeve të mëdha kapitale (kryesisht në rrugë dhe të tjera vepra të infrastrukurës publike), QSH ka reaguar shpejt me shkurtime shpenzimesh për të sjellë balancën e përgjithshme fiskale në nivele rreziku me të ulët. Shkurtime të kryesore kanë qenë në shpenzimet kapitale, gjë që tregon një vetëpërmbytje të QSH-së për të prekur shpenzimet e lidhura me programet dhe politikën që kanë pasojë sociale. Defiçiti ka qenë i financuar kryesisht nga burime të brendshme, kështu që borxhi i Shqipërisë nuk ka qenë dhe aq shumë i ekspozuar ndaj rreziqeve të levizjeve lart/poshtë të tregjeve financiare botërore. Megjithatë, rrugedalja ndaj burimeve të brendshme të huamarrjes ka patur një ndikim direkt në uljen e kreditit të disponueshëm për individët dhe sektorin privat në funksion të financimit të mundësive të rritjes ekonomike, gjë që reflektohet dhe në nivele më të ulëta të kontributit të sektorit të ndërtimit dhe pasurive të patundshme në rritjen e ekonomisë pas vitit 2009³. Parlamenti në fundi (dhjetor 2012) vendosi të modifikojë Ligjin Organik të Buxhetit, i cili përshkruante një nivel 60% të PBB si limiti absolut i borxhit publik. Kjo levizje u justifikua me nevojën e vendit për të krijuar me tepër hapësirë për levizje kundra balancues në anën e kërkesës për të përballuar presionin në rritje mbi financat publike të ritmeve të rritjes së PBB në ulje. Si e tillë ajo i hapi rrugën levizjeve në të njëjtin drejtim që u kryen pas zgjedhjeve të qershorit 2013. Në tetor 2013, parlamenti i ri vendosi të rishikojë buxhetin vjetor duke ulur nivelin e të ardhurave të parashikuara, gjë e cila solli

¹ "Albania at a glance", World Bank, Country Data, 17/03/2013

² Raporti i Politikës Monetare, BA, Janar 2014

³ "Albania at a glance", World Bank, Country Data, 17/03/2013

drejtpërdrejt rritjen e deficitit fiskal dhe për arsye të rritjes së huamarrjes së brëndshme për të përballuar nevojat e shpenzimeve publike ne fakt solli dhe rritjen e nivelit të përgjithshëm publik i cili mendohet se do të arrijë në 70% të PPB në fund të 2013. Në nëntor 2013, QSH deklaroi që ky borxh ish edhe më i lartë për shkak të pageave të prapmbetura ndaj sektorit privat, shuma e të cilave aktualisht vlerësohet të jetë më tepër se 200 ml €. Në përfundim të një procesi konsultimi me FMN dhe BB, që çuan në një marrveshje huaje me terma të butë me FMN dhe mbështetje buxhetore me BB, QSH u angazhua të paguajë këto borxhe në mënyrë graduale në periudhën 2014-2016, gjithësesi me çmimin e ngritjes akoma më tej të borxhit publik, i cili në versionin më pensivist mund të arrijë mbi 85% të PPB në fund të 2015¹. Ky nivel e bën Shqipërinë një nga vendet me nivele më të larta të borxhit në Europën Qëndrore dhe Lindore (me përjashtim të Hungarisë), gjë e cila, nëse nuk përballohet me ritme të larta të rritjes ekonomike, përbën një rrezik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik/social të vendit.

Duke vazhduar ne fushen e financave qeveritare, te ardhurat tatimore ne Shqiperi jane pak me teper se 23% e PPB², e cila tregon nje nivel pak a shume te mire kur dihet qe vendi aplikonte sistemin e takses se sheshte ne nivelin 10% si per tatimin mbi fitimin (TF) ashtu dhe per tatimin mbi te ardhurat personale (TAP). Zhvillimet e reja në këtë drejtim kanë të bëjnë me Paketën e Re Fiskale, e cila do të bëhet efektive duke nisur nga 1 Janari 2014. Ajo do të bëjë kalim nga taksa e sheshtë në atë progresiv për të dy tatimet (TF/TAP). Kjo lëvizje nuk është e papritur, përderisa, burimi kryesor i te ardhurave tatimore mbetet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), qe tregon se Shqiperia ka ende shume per te ecur ne rrugen e krijimit te nje sistemi te plote dhe te ekuilibruar nga pikepamja e barres fiskale mbi kapitalin dhe konsumin. Gjithësesi, modalitetet dhe cilësia e kësaj pakete në lidhje me kriteret klasike të një sistemi taksash (barzazia horizontale/vertikale, efijensa, përshatshmëria, siguria etj) mbeten për tu parë.

Shpenzimet, pavarësisht pikut ne vitin 2009, per shkak te programeve te medha te investimeve publike, jane shkurtuar ne vitet ne vazhdim per te mbajtur nen kontroll defijitin fiskal ne nivelin e 3.5%-4% of PPB si shenje e maturise ekonomike; shpenzimet per pushtetin lokal kane qene pak a shume te qendrueshme ne vitet 2008-2012 brenda rangut te 2-2.5% of PPB. Në anën e shpenzimeve publike, çfarë ish projektuar për tu realizuar në gjithë 2013, është realizuar pothuajse krejtësisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2013. Gjatë vitit 2014, qeveria ka vendosur të mbetet e kujdesshme dhe të financojë vetëm projektet e filluara tashmë; një lëvizje e tillë mendohet se do të përmirsojë bilancin fiskal dhe do t'i japë me tepër hapësirë sektorit privat për shkak të stimulit fiskal (pagesa e borxheve të prapambetura dhe ekekti shumëfishuesh i tyre).

Per vitet ne vazhdim, parashikimet e meparshme makroekonomike te QSH-se ishin te rendit 5-6% ritem rritje te PPB real, qe ishin me teper se optimiste duke patur parasysh zhvillimet e fundit negative ne vendet partnere kryesore tregtare te Shqiperise: Itali dhe Greqi. Megjithate, nje skenar i ri u gjenerua ne fillim te vitit 2013, i cili merr me mire parasysh keto zhvillime dhe ul parashikimet e meparshme. Gjithmone duke iu referuar ketij skenari, ritmet e rritjes reale te PPB per vitin 2012-2013 do te jene 1.5-3.5% qe gjithsesi mbeten me te larta se ritmet e rritjes te gjeneruara nga FMN, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Boterore (BB) të cilat janë ne intervalin 0.5-1.3% per te njëjtën periudhë. Të dhënat e deritanishme tregojnë që parashikimet këtyre institucioneve ndërkombëtare kanë gjasë të jenë të sakta.

1.2 Mjedisi Politik

Situata politike ne Shqiperi mund te pershkruhet me mire duke analizuar progresin e Shqiperise ne aderimin ne BE, si lokomotiva kryesore e reformave demokratike, te qeverisjes dhe ekonomike ne vend..

Aplikimi i Shqiperise per anetaresim ne BE me 28 prill 2009, u konsideruar si nje etape e rendesishme ne tranzicionin e Shqiperise nga nje vend komunist ne nje vend me demokraci te konsoliduar dhe ekonomi tregu.

Situata politike gjate 2009-2012, e cila korrespondon me jetegjatesine e dldp-se, eshte tensionuar te pakten dy here per shkak te debatit politik ndermjet partive kryesore, Partise Demokratike (PD) ne qeveri dhe Partise Socialiste (PS) ne opozite, si pasoje e zgjedhjeve parlamentare te vitit 2009 dhe zgjedhjeve lokale 2011. Te dy proceset zgjedhore u vezhguan nga OSBE dhe ODIHR, te cilat theksuan qe megjithese zgjedhjet treguan progres te prekshem dhe permiresime te ndryshme, prape keto permiresime u zbehen nga politizimi i aspekteve teknike te procesit.

¹ Statistikat te BB dhe FMN

² Te dhena nga MoF ne Raportin Ekonomik dhe Fiskal te 2013

Kontestimi i rezultateve zgjedhore ka çuar ne ngerç politik te shenjuar nga bojkoti parlamentar i opozites, i cili mbaroi ne shtator 2011, kur PS vendosi te hyje ne Parlament ne menyre qe t'i jape nje shtyese perpjekjeve te Shqiperise per te permbushur kriteret e pranimit ne BE. Nje marreveshje politike midis partise qeveritare dhe atyre ne opozite mbi planin dhe kalendarin e reformes elektorale, permiresimin e rregullave dhe procedures parlamentare dhe aprovimin e ligjeve qe kerkonin shumice te cilësuar, u hartua menjehere pas nentorit 2011.

Rezultatet gene mbreselenese:

- Shume nga ligjet qe kerkonin nje shumice te cilesuar u aprovuan.
- U emerua Avokati i Popullit me nje proces dhe kandidat te zgjedhur nga opozita dhe duke gene dakord me partine qeverisese.
- Seanca degjimore dhe votimi parlamentare u mbajten me sukses per emerimin e njw gjykatesi ne Gjykatën e Larte.

Me 11 qershor 2012, u zgjodh presidenti i ri ne perputhje me amendamentet kushtetuese megjithese pa konsensusin e opozites. Perseri ky fakt kontribuoi ne nje tension te ri te panevojshem politik dhe demtoi perpjekiet per reforma ne fusha kyçe te cilat kerkojne konsensus politik dhe qe motivuan Komisionin Evropian qe Shqiperise t'i jepet statusi i kushtezuar i vendit kandidat per ne BE.

Me 12 dhjetor 2012, Keshilli dhe Parlamenti Evropian, megjithese pershendeten progresin ne teresi te shenuar nga Shqiperia, sipas raporteve monitoruese te Komisionit Evropian, vendosen qe t'i akordojne Shqiperise statusin e vendit kandidat vetem kur progresi i nevojshem te arrihet ne disa fusha si ajo e gjyqesorit, reformes se administrates publike dhe rishikimit te rregullave dhe procedurave parlamentare, te cilat mund te arrihen vetem mbi bazen e konsensusit politik midis pales qeverisese dhe opozites. Ne vazhdimesi u theksua po ashtu qe "Mbajtja e zgjedhjeve te suksesshme parlamentare ne vitin 2013 do te jete nje test kryesor per funksionimin e mire te institucioneve demokratike ne vend".

Muajt e pare te vitin 2013, jane shoqeruar me debate dhe diskutime te ashpra politike, te cilat jane gjithmone te pranishme ne mjedisin politik shqiptar sidomos ne vitet elektorale siç eshte dhe rasti i ketij viti me zgjedhjet parlamentare qe ishin programuar per tu mbajtur me 23 qershor 2013. Pavarsisht, zgjedhjet u mbajten ne nje atmosfere te qete dhe tranzicioni i pushtetit nga koalicioni me ne krye PD ne ate te PS (qe fitoi zgjedhjet) u be ne menyre te bute- kjo u konsiderua nga te gjithë partneret nderkombetare te Shqiperise si nje shenje e maturise se institucioneve dhe sistemit demokratik ne Shqiperi dhe pritej qe vendi me ne fund te fitonte statusin e vendit kandidat. Komisioni evropian rekomandoi plotesisht qe Shqiperise t'i jepej ky status per shkak te arritjeve dhe sepse kish permbushur, madje pertej ç'shpresohej, angazhimet e marra. Megjithatë, në dhjetor 2013, pas një votimi parlamentar në Hollandë dhe votimit në Këshillin Europian të disa nga ministrave të jashtëm të vëndeve anëtarë të BE (Gjermania, Franca, Anglia, Danimarka), u vendos që vendimi për statusin e Shqipërisë si vënd kandidat të shtyhet për në qershor 2014, me kusht që Shqipëria të mbetet e angazhuar në rrugën e reformave te mëtejshme për luftën kundër korrupsionit dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Reagimi qe pasoi ne mjedisin kombetar qe nje perzierje e pakenaqsisë, zhgjenjimit dhe keqardhjes. Si gjithmone, partite politike por tani me role te ndryshuara (pozite/opozite) filluan dhe vazhdojne te fajesojne njera-tjetren si pergjegjese per vendimin e BE, duke krijuar keshtu nje arene te re debati politik se paku per gjysmen e pare te 2014.

1.3 Decentralizimi, gjendja aktuale

Duke dale nga pothuajse 50 vjet praktike e qeverisjes totalisht te perqendruar, Shqiperia hyri ne rrugen e decentralizimit ne fund te viteve '90. Vendi ratifikoi Kartën Evropiane te Vetëqeverisjes Lokale, perfshiu parimet e saj baze ne Kushtetuten e re dhe kaloi reformat ligjore per veteqeverisjen lokale pas vitit 1998. Nje Strategji Kombetare per Decentralizimin dhe Lige Organike per Qeverisjen Lokale u aprovuan per here te pare ne vitin 2000 dhe kane gene rishikuar te pakten dy here qe atehe. Keto ligje organike mbi "Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal" (Ligji 8652) dhe mbi "Ndarjen Administrative dhe Territoriale" (Ligji 8653) i dhane fund praktikës se Keshillave te vjeter te Rretheve dhe ndertuan per here te pare nje kuader ligjor qe lejonte struktura te decentralizuara fiskale dhe administrative funksionale, te cilat ne parim perfshijne qarqet, bashkite dhe komunat.

Pa dyshim qe procesi i decentralizimit nuk mund te jete efektiv pa qene i shoqeruar nga procesi i decentralizimit fiskal: nivelet e qeverisjes lokale (qarqet, bashkite dhe komunat) kane nevojë te kene

burime te parashikueshme te dhenash nen fuqine e tyre ne menyre qe te ushtrojne ne menyre te pavarur funksionet e tyre dhe te ofrojne ne menyre efektive/eficiente sherbime publike per komunitetet e tyre. Ne Shqiperi te ardhurat e NJQV-ve jane me te uletat ne gjithe Europen Juglindore me 3.1% te PPB¹. Shqiperia nuk ka nje sistem te ndarjes se taksave, te pakten ne lidhje me TAP dhe TF; kuptohet qe shumica e te ardhurave te NJQV-ve vijne prej transfertave te kushtezuara dhe te pakushtezuara qeveritare. Duke patur parasysh renien e ritmeve te rritjes ne vitet e fundit, NJQV-te jane ne fakt ne situatë shtrengese buxhetore, per pasaoje eshte paresore qe te konsolidohen praktikat fiskale dhe ato te drejtimin te financave publike ne menyre qe te akomodohen rreziqet ne afatin e shkurter dhe te mesem.

Pavarësisht nje kuadri ligjor pak a shume funksional qe rregullon punen e NJQV-ve, duket sikur ka disa hendeqe sidomos te lidhur me ndarjen e qarte dhe efektive te roleve/pergjegejsive ne lidhje me disa nga aktivitetet e qeverisjes lokale (per shembull pergatitjen, zbatimin dhe kontrollin e PBA-se dhe buxheteve vjetore ne nivel lokal dhe rajonal, shkallen e transparencës etj). Ligji mbi Financat Lokale, i cili mund te kishte siguruar nje kuader ligjor solid per keto role/pergjegjisi, pavarësisht faktit qe eshte hartuar qe ne vitin 2008, nuk eshte ende ne zbatim. Çdo vendim i ardhem i dldp per te asistuar NJQV-te ne procesin e zbatimit te buxhetit ne afat te shkurter/gjate eshte pra subjekt i dakortesise politike dhe aprovimit te ketij ligji, i cili ka rrjedhoja sidomos per aktivitetet te rendesishme te zbatimit te buxhetit si auditin i brendshem dhe kontrollin, prokurimet publike etj.

Ne drejtim te shperndarjes territoriale/popullates, Shqiperia akoma ka nje sistem te qeverisjes lokale me shume NJQV te vogla. Aktualisht jane 373 NJQV nga te cilat pothuajse 41% kane nje popullate me te vogel se 5000 banore. Kjo shperndarje e ben eficienten e sherbimeve publike ne nivelin lokal shume te veshtire per t'u arritur; prandaj eshte e kuptueshme perse ka nje ngurrim ne nivel qendror per te deleguar me teper pushtet dhe autonomi ne nivel lokal per sigurimin e sherbimeve publike. Megjithate, nevoja e avancimit ne kete drejtim eshte pranuar nga autoritetet qendrore dhe aktoret politike dhe se fundi ka nje konsensus ne rritje ne shkalle vendi qe Shqiperia ka nevojte te reformoje strukturat e administrimit territorial ne menyre qe te avancoje me teper procesin e decentralizimit fiskal dhe permiresoje praktiken e sherbimeve publike ne nivel lokal. Te dhenat e fundit e censusit te publikuara nga INSTAT-i ne fund te vitit 2012, priten te sigurojne nje baze te mire per kete reforme te shperndarjes territoriale dhe rrjedhimisht per caktimin e shpenzimeve dhe te ardhurave ne menyre qe te ushtrohen funksionet ekskluzive, te perbashketa dhe te deleguara te NJQV-ve. Se fundi me parlamentin e ri te dale nga zgjedhjet e pergjithshme te qershorit 2013, ka nje levizje te rendesishme per te filluar me reformen e re administrative dhe territoriale ne konsultim te gjere me te gjitha palet e interesuara. Objektivi i qeverise se re eshte ta realizoje kete reforme ne gjysmen e pare te vitit 2014. Megjithate procesi i konsultimit me opoziten ka per te qene i veshtire duke patur parasysh interesat elektorale ne entitetet e reja. Per te folur objektivist, eshte nje sfide po ashtu dhe per autoritetet lokale dhe aktoret e tjere jopolitike per arsye te kohes, kriteret te perdorura dhe situates politike.

Aktualisht kuadri ligjor lejon te gjitha NJQV-te te ushtrojne funksione ekskluzive, te perbashketa me pushtetin qendror dhe te deleguara mbi bazen e percaktimit te shpenzimeve pa konsideruar mjaftueshem kapacitetet e tyre financiare, teknike dhe njerezore per te siguruar sherbime publike ne menyre eficiente. Kur vjen çështja sidomos tek funksionet e perbashketa si shkollimi parauniversitar, sherbimi primar shëndetësor, furnizimi me uje dhe kanalizimet, mbrojtja e mjedisit dhe mbrojtja sociale, pamundesia e zyrtareve lokale per te ofruar sherbime efektive, duket se u ka dhene udhe deshtimeve qe jane amplifikuar ne shkalle kombetare nepermjet debateve te panevojshme politike ndermjet aktoreve politike.² Megjithese funksionet e ndara jane te justifikueshme nga pikëpamja ekonomike dhe sociale, ne Shqiperi, ka nevojte qe politika dhe praktika e percaktimit te shpenzimeve te bazohet gjithashtu dhe ne te qenurit gati dhe vullnetin e qeverisjes lokale ne te gjitha nivelet (komuna, bashki dhe qarqe) ne menyre qe te sigurohet permirësimi i sigurimit te sherbimeve publike per komunitetet lokale ne terma afatshkurter dhe afatgjate. Per aq kohe sa ne Shqiperi ka efektivist dy shoqata te NJQV-ve me perkatesi te dalluara politike (nje ndaj qeverisjes aktuale dhe tjetra ndaj opozites), arritja e nje marreveshjeje qe funksionon ne kete drejtim mbetet ende nje sfide.

Nje pamje e tille e ngjashme eshte e pranishme gjithashtu dhe ne anen e percaktimit te te ardhurave. Ne Shqiperi, NJQV-te kane ende pak burime te ardhurash nen fuqine e tyre. TBV³ e cila u mendua si nje nga shtysat e rritjes se nivelit te te ardhurave lokale nuk qe efektive:

¹ Indikatoret e Decentralizimit Fiskal te Europes Juglindore, Rrjeti NALAS, 2012.

² Nje shembull i mire ne kete pike ka te beje me sherbimin e ujesjellesave dhe kanalizimeve ne nivel lokal per shkak te borxheve te keqija te akumuluar ndaj Kompanise se Shperndarjes Elektrike CEZ ne gjysmen e dyte te vitit 2012.

³ Subjektet qe paguajne TBV nuk jane subjekte qe i nenshtrohen TVSH.

- sepse niveli maksimal i saj deri me tani ka qene i ndikuar nga niveli i takses se sheshte prej 10% te aplikuar nga QSH.
- sepse baza e kesaj takse ka ardhur duke u ngushtuar si pasoje e disa vendimeve te MF-se per te ulur nivelin e qarkullimit te pergjithshem mbi te cilin aplikohet TVSH-ja, e cila ka perzier pergjegjesite e administrimit te takses se biznesit te vogel midis qeverise qendrore dhe lokale.

Nje tjeter burim i mundshem i te ardhurave, taksa mbi pronesine, pavarësisht potencialit per te siguruar te ardhura te rendesishme per NJQV-ne me numrin me te madh te banoreve ka ende nje baze te vogel per shkak se progresi ne legalizimin e ndertimeve informale dhe zgjidhja e diskutimeve midis ish-pronarve dhe te ardhurve te rinj eshte i ngadalshem si pasoje e tensioneve politike dhe sociale. Pavarësisht premtimeve per nje zgjidhje te shpejte ne procesin e legalizimit dhe formalizimit te ketyre ndertimeve gjate fushates elektorale, lideret politike aktualisht ne pushtet po kuptojne qe zgjidhja e legalizimit te ketyre ndertimeve informale duke u paguar çmimin e tregut ish pronareve nuk eshte e arritshme, per rrjedhoje duhet te kerkohet nje zgjidhje e re e cila kerkon kohe sidomos ne realitetin shqiptar ku marreveshja dhe kompromisi jane te veshtira per tu arritur.

Duke patur parasysh te gjitha sa u thane me siper, nuk duhet te tingelloje si surprize fakti perse burimet me te rendesishme te te ardhurave per NJQV-te mbeten transfertat qeveritare ne formen e transfertave te kushtezuara dhe te pakushtezuara. Ketu, pavarësisht nje niveli stabel te shpenzimeve te paracaktuara per pushtetin lokal prej 2-2.5% te PPB, transfertat per te dyja kategorite ne periudhen 2009-2011 kane ardhur duke u ulur ne buxhetet nacionale per shkak te performances se ulur ne te dyja aspektet, PPB dhe mbledhje e te ardhurave. Praktika e shperndarjes te transfertave te pakushtezuara nepermjet Fondit te Zhvillimit Rajonal nepermjet granteve konkurrese u mendua qe te rriste eficënsen, pershtatjen me planet strategjike dhe konkurreshmerine midis NJQV sidomos ne fushen e investimeve dhe shpenzimeve kapitale. Megjithate, ne kete aspekt disa nga nga problemet qe duket se kane NJQV-te jane nje shporte me e vogel per te shperndare çdo vit, rregulla te diskutueshme ne zgjedhjen e projekteve dhe pershtatje ndaj planeve kombetare si prioritet ndaj atyre rajonale. Aktualisht niveli i granteve te pakushtezuara te transferuara ndaj NJQV-ve, percaktohet mbi bazen e nje formule te barazimit, e cila eshte e veshtire per tu kuptuar nga pikëpamja intuitive, kjo i ka dhene rruge sugjerimeve per mekanizma me te thjeshte te pjesemarrjes/ndarjes se te ardhurave per taksat kryesore si TF, TAP apo TVSH, gjithmone duke futur mekanizma kontrolli per te garantuar drejtesine dhe eficënsen e rezultateve.

Persa i perket burimit te te ardhurave nepermjet borxhit, megjithese i bazuar ne ligjin “Ligji per Huamarrjen e Pushtetit Lokal” (2008), aftesia e NJQV-ve ne praktike per te vepruar ne kete drejtim ne 3 vitet e fundit ka qene e kufizuar nga “Ligji Organik i Buxhetit” (2008) i cili postulonte nje nivel maksimum borxhi prej 60% dhe nivelet aktuale te borxhit publik te qeverise qendrore qe kane qene pothuajse afer nivelit limit.

1.4 Dldp, vështrim i përgjithshëm

Programi për decentralizim dhe zhvillim lokal (*Dldp*) eshte pjese e strategjise te Kooperacionit Zviceran SDC/SECO per te mbeshtetur Shqiperine ne perpjekjet e saj per te avancuar procesin e demokratizimit dhe forcimit te ligjit. Ne veçanti, programi synon te mbeshtese procesin e decentralizimit ne Shqiperi ne menyre qe te konsolidoje demokracine dhe te siguroje standardet evropiane te sherbimit publik per qytaret si nje element thelbesor i Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim. Shtrirja gjeografike e programit mbulon 33 Njesi te Qeverisjes Vendore (NJQV) ne Qarkun e Shkodres dhe 21 ne ate te Lezhes. Popullsia totale ne rajon arrin ne 554000 banore, nga te cilet 40 % jetojne ne zona urbane dhe perafersisht 30 % jetojne nen nivelin e varferise (sipas vleresimeve zyrtare ne 2004).

Ne menyre te permbledhur faza aktuale 2 e dldp-se, e cila qe programuar per tu zbatuar ne hapesiren kohore midis periudhes mars 2010 -mars 2013, mund te pershkruhet si me poshte :

Qëllimi i Programit: Kapacitetet e bashkive dhe komunave ne Shkodër dhe Lezhë janë forcuar duke kontribuar në zhvillimin rajonal në Shqipërinë Veriore dhe reformën e decentralizimit në nivel kombëtar		
Përfundimi i Synuar	1: Bashkitë dhe Komunat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmiresuar strukturat qeverisëse, kapacitetet dhe shërbimet publike të caktuara.	2: Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkepunim me shoqatat duke ndikuar keshtu ne ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar.
		
	1.1 Kapacitetet e NJQV në planifikim strategjik	2.1 “Qendrat e Kompetencës” janë identifikuar,

Produkte	dhe buxhetim janë përmirësuar dhe NJQV e zgjedhura aplikojne instrumente dhe metoda të planifikimit strategjik të lidhura me buxhete vjetore dhe afatmesme.	praktikat e mira janë dokumentuar dhe shpërndare/ndarë me bashki dhe komuna të tjera në bashëpunim me Shoqatën e Bashkive (AAM) dhe Komunave (AAC)
	1.2 Kapacitetet e NJQV-së në manaxhimin financiar dhe fiskal , duke përfshirë proceset e buxhetimit afatmesem janë forcuar.	2.2. Shoqatat e forcuar (AAM dhe AAC) janë të afta të përfaqësojnë interesat e qeverisë lokale : procese konsultimi në ligj dhe berjen e politikave, ngritja e kapaciteteve për NJQV ndikon efektivisht në zbatimin e reformës së decentralizimit.
	1.3 Sherbimet publike të zgjedhura janë përmirësuar duke siguruar akses të barabartë për të gjithë qytetarët, përfshirë gratë dhe grupet e varfra apo të marginalizuara.	2.3 Praktika e mire dhe ekspertiza e zgjedhur kontribuon në dialogun mbi politiken kombëtare.
	1.4 Mekanizma novatorë të komunikimit dhe informacionit janë aplikuar nga NJQV-ja duke rritur transparencën dhe aksesin në informacion cilësor dhe shërbime për të gjithë qytetarët.	2.4 Sigurohet lidhja dhe shkëmbimi me programe dhe projekte në veçanti me Këshillin e Evropës .
	1.5 Qarku kontribuon ne rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis NJQV-ve.	

1.5 Një Vështrim mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Rishikimit të Fundit të Programit

Rishikimi i fundit i programit u krye nga dy eksperte te jashtme (Lena Krylova dhe Ornella Shapo) ne tetor 2011. Gjetjet, rekomandimet dhe mesimet e nxjerra mund te pershkruhen si me poshte:

Përfundimet e Synuara	1: Bashkitë dhe Komunitat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmirësuar strukturat qeverisëse, kapacitetet dhe shërbime publike të caktuara	2: Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkëpunim me shoqatat duke ndikuar kështu në ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar
Gjetje	- Janë zhvilluar produkte cilësore dhe të konsultuara gjerësisht ; - Është siguruar zhvillimi i kapaciteteve relevante që i përgjigjet nevojave të veçanta të NJQV-ve; - Manuali i Grantit të dldp-se shërben si material mësimor për fondet të tjera në shumë drejtime; - Eshtë siguruar mbështetje e suksesshme për rritjen e grave politike ne kontekstin e zgjedhjeve lokale (maj 2011) . - Dldp-ja eshte tepër e rëndësishme (pavarësisht mungesës së një kuadri të politikës së decentralizimit) dhe me përfundime të rëndësishme qe i përgjigjen nevojave të veçanta të NJQV-ve, të cilat janë partnerët kryesorë të programit.	- Dldp-ja është një projekt i mirënjohur; - Dldp-ja adreson një gamë të gjerë çështjesh tematike të rëndësishme; - Dldp-ja ka bashkëpunuar me sukses me shoqatat e NJQV-ve për t'i patur ato si aktorë me rëndësi në debatin e politikës së decentralizimit pavarësisht kontekstit të vështirë; - Koordinimi me projekte të tjera të SDC-së në të njëjtën fushë nuk ka qenë realizuar ende pavarësisht të qendrimit pro-aktiv të dldp-së - Konsultimi dhe harmonizimi me të tjera programe të bëhet kurdoherë që të jetë relevante.
Rekomandime	- Të ngushtohet gjerësia tematike e programit në modelet e suksesshme, - Rritje të mëtejshme për efektivitet dhe ndikim të rritur duke konsideruar më mirë raportin kosto/efekte të mjeteve dhe paketave të mbështetjes, - Përcaktim i qartë i ndarjes së punës midis PZHR-së (programit të zhvillimit rajonal) dhe Dldp-së, - Sugjerim i përshkallëzimit të paketave të informacionit dhe komunikimit dhe - Përmirësim i sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit të dldp-së.	- Të përcaktohen kanale të qarta të përshkallëzimit të produkteve të dldp-së, - Të rritet pronësia e produkteve/paketave nga grupet e interesit në nivel kombëtar, për të lehtësuar më tej shpërndarjen e produkteve dhe praktikave më të mira - Te vazhdohet me punën me shoqatat për zhvillimin e produkteve si dhe për përhapjen e tyre.

Ne shkurt-mars 2013, autori i ketij vleresimi realizoi nje tjetër vleresim te arritjeve dhe deshtimeve te programit per komponentet PSZH/PBA, gjetjet dhe rekomandimet e te cilave jane paraqitur me poshte

Përfundimet e Synuara	1: Bashkitë dhe Komunat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmirësuar strukturat qeverisëse, kapacitetet dhe shërbime publike të caktuara
Gjetje	- Aktualisht, ne kontekstin e uljes se ritmeve te rritjes ekonomike, mjedisi i pergjithshem ne Shqiperi per zhvillimin e trajtimeve strategjike ne fushen e manaxhimit te financave publike ne nivel lokal eshte sfidues. Si i tille ai ka te beje me burime financiare ne ulje per pushtetin lokal si pasoje e transfertave ne ulje nga pushteti qendror, dmth shtrengesa buxhetore qe detyrojne pushtetin lokal te perqendrohet ne perballimin e realitetit te zgjidhjeve te perdritshme me teper se ne aspektet e vendimeve te lidhura me proceset strategjike dhe ato te manaxhimit te financave publike ne nivel lokal. - IPF eshte nje mjet i dobishem, i cili nepermjet hapave teper analitike ne procesin e pergatitjes se buxhetit afatmesem, ka mundesine te shtojte qartesine dhe realizem procesit te pergatitjes se PSZH. - Pavarësisht koheve te veshtira, njesite e qeverisjes vendore, dldp-ja, jane duke levizur drejt proceseve standarde te planifikimit strategjik ne fushen e manaxhimit te financave publike, rezultatet e te cilave duket te çojne ne vendime me cilesore nga pikepamja e arritshmerise se programeve dhe aktiviteteve. - Ndryshimet midis PBA dhe buxheteve vjetore vazhdojne ende te mbeten te medha dhe pavaresisht permirsimeve rrezikohen nga burime te pasigurta si pasoje e parashikueshmerise se ulet te transfertave nga qeveria qendrore. - Perdorimi i mjeteve standarde te planifikimit buxhetor afatmesem ka rritur cilesine e perpilimit te PBA, per rrjedhoje produkti IPF ka sjelle perfitime te medha per përfundimet e synuara te programit. Gjithsesi, ka nevojë qe mjete te tilla te përmirësohen akoma me tej nepermjet futjes se standardeve kombetare sidomos ne kodifikimin dhe klasifikimin programatik te shpenzimeve ne menyre qe te përmirësohen akoma me tej mundesite e shtrirjes ne zona te tjera dhe te gjenerohet mbeshtetje per produktet e dldp-se. - Pavarësisht progresit modest ne parashikueshmerine e buxheteve, mbetet ende per te bere ne menyre qe te rritet thellesia dhe qendrueshmeria e PBA si mjete monitorimi per planifikimin buxhetor. Perderisa ka zhvillime te reja ne lidhje me borxhin publik, eshte e nevojshme qe programi te marre ne konsiderate mundesine e integritit te vleresimit te borxhit ne IPF dhe ne PBA qe shkojne pertej shpalljes se thjeshte te shumes se huave apo kredive. - Pavarësisht informacionit pak a shume te disponueshem per publikun ne procesin e pergatitjes se buxhetit, cilesia e tij ka nevojë te përmirësohet. Ritmet e rritjes ekonomike jane ende shume te thjeshta dhe te paargumentuara ne PBA dhe ne PSZH. - Perfshirja e autoriteteve rajonale si grupe te interesit dhe pale ne procesin e pergatitjes se PBA dhe PSZH duket problematike. Po ashtu, prioritetet/mundesite rajonale dhe kombetare jane ende larg integritit ne PSZH nepermjet nje kuadri sistematik te vleresimit te ketyre mundesive. - Cilesia dhe sasia e PSZH jane permiresuar me kalimin e kohes. Programi dldp duket se ka luajtur nje rol te rendesishem ketu nepermjet komponentit te tij te aktiviteteve te perqendruara ne ndertimin e kapaciteteve dhe procesit te konsultimit ndermjet eksperteve te NJQV-ve. Megjithate PSZH-te ne menyre te pergjithshme kane mungesa te shprehjes se aktiviteteve ne kosto sipas nje standardi te perbashket ne harmoni me PBA, mekanizmat monitorues, entitetet pergjegjese per zbatimin e aktiviteteve, shprehjen ne terma sasiore te rreziqeve dhe veprimet qe duhen te ndiqen ne rast se keto rreziqe materializohen. Metodologjite e shqyrtimit dhe te vleresimit te mjedisit (SWOT ose te ngjashme me te) jane prezente vetem ne disa nga PSZH e zhvilluara. - Aktivitetet e ndertimit te kapaciteteve jane zbatuar sipas programit dhe ne pergjithesi kane rezultuar mire sipas kuadrit logjik te monitorimit. Kriteri i gjinise eshte respektuar, gje qe tregon vetedijen e programit per domethenien e ketij kriteri ne mjedisin shqiptar. - Pavarësisht permirsimeve ne forme dhe ne cilesine e PSZH, ende nuk ka nje reflektim ose vendimarrje ne lidhje me integritin e kohezgjatjes se ketyre strategjive dhe procesit te rishikimit. - Zgjedhja e strategjise se instruktimit ka qene shume efektive ne përmirësimin e cilesise se PBA dhe PSZH te zhvilluara. - Ne lidhje me metodologjine e kombinimit te PSZH dhe PBA ne nje te vetme ne procesin e zbatimit te ketij programi, rekomandohet qe programi te vazhdoje ne te njejten rruge. Proceset, mjetet dhe standardet tashme te zhvilluara do ta bejne koston e aktiviteteve te ardhshme me te ulet dhe perfitimi do te jete me i madh. Megjithate, çdo program i ri duhet t'i kushtojë vemendje pershtatjes me standardet kombetare ne menyre qe te promovohet dhe sigurohet qendrueshmeria e rezultateve te arritura ne te ardhmen.

Rekomandime

- Programi ka nevojë që të kapitalizojë në iniciativat, standardet, udhëzimet rajonale dhe kombëtare në mënyrë që të rrisë ndikimin e tij veçanërisht në fushat që kanë një lidhje direkte me menaxhimin e financave publike (disponueshmëria e informacionit të buxhetit, kanalet e komunikimit, kalendari i aprovimit të buxhetit, struktura e raporteve dhe formatet e buxhetit etj.)
- Ka nevojë për më tepër punë në mënyrë që PBA-të të jenë mekanizma që jo vetëm t'i shërbejnë procesit të hartimit të PSZH por edhe të monitorimit të tij. PBA ka nevojë që të behen programe me indikatorë, rreziqet perkatese, përgjegjësi dhe veprime që duhet të kryhen nëse objektivi i synuar nuk arrihet.
- Është e nevojshme përshtatja me iniciativat në nivel kombëtar për të rritur mënyrë dhe shtrirjen e të ardhurave lokale me të tjera taksa ose për të krijuar "zona relativisht të sigurt" për të ardhurat lokale në mënyrë që të garantohet siguria e parashikimeve fiskale të të ardhurave/shpenzimeve lokale dhe rrjedhimisht shërbimet publike.
- PSZH të integrojë një shqyrtim të detajuar të mundësive rajonale dhe kombëtare dhe të përmbajë plane veprimesh sa më afër realitetit nepermjet PBA.
- Mjeti i Planifikimit Financiar (IPF) të shtrihet në pjesën e mbetur të komunave me përmirësime shtese të pershtatura me zhvillimet kombëtare; si një shembull ilustrimi, programi mund të mendojë për mundësinë e zgjerimit ose të shtimit të një moduli të dedikuar borxhit.
- Është e nevojshme që dldp-ja të kapitalizojë dhe promovojë disa nga materialet e zhvilluara në programe si shembuj të praktikave të mira dhe të mbështesë çdo iniciativë kombëtare për ushtrime standarde në fushën e menaxhimit të financave publike (si p.sh. PEFA lokale- shkurt Shqyrtimi i Kuadrit të Shpenzimeve Publike në nivel lokal), të cilat mund të rrisin vetedijen rajonale dhe kombëtare për programin dhe suportin për perfundimet e synuara të tij.
- Praktika e konsultimeve ndërmjet ekspertëve të NJQV duhet të jetë pjesë e procesit dhe kurdoherë që të jetë e mundur duhet të përfshijë përfaqësues nga niveli rajonal dhe kombëtar i qeverisë në mënyrë që të lehtësojë përfshirjen e tyre në procesin e PBA dhe PSZH dhe të rrisë ndikimin përtej zonës së programit.

Metodologjia e përdorur dhe indikatorët që u përdorën u adoptuan nga metodologjia PEFA, megjithatë ato u përdorën vetëm për të trajtuar vetëm procesin e planifikimit strategjik dhe atë të buxhetimit afatshkurter dhe afatmesëm. Një listë e detajuar indikatorësh dhe metodologjia e matjes së tyre është e shpjeguar në ANNEX 1.

2 OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TEMATIK

2.1 Qëllimi i këtij ushtrimi

Ajo që jepet më poshtë jep një kuader në teresi për këtë ushtrim, i cili u realizua me kërkesën e dldp në dhjetor 2013.

Objektivi i këtij vlerësimi ish që të vlerësojë cilësia e paketave fiskale të ndërtuara me ndihmën e programit, domethenia e metodologjisë së përdorur, dhe të japin rekomandime të metejshme për përmirësimin e metejshëm të cilësive së tyre.

Në mënyrë më specifike ky ushtrim synonte të jepte një vlerësim në lidhje me drejtëtimet e mëposhtme:

- metodologjia e përdorur për të ndërtuar paketat fiskale dhe rekomandime për përmirësimin e tyre
- përmbajtja e paketave fiskale, saktësia dhe rekomandime për përmirësim
- konsistenca e paketave fiskale me IPF dhe PBA-të, të nxirret në pah çdo ndryshim pozitiv që ka ndodhur si pasoje e asistencës së dhënë nga programi.

Për sa më sipër, gjithë puna e vlerësimit është bërë duke iu referuar aktivitetëve të programit në lidhje me procesin e planifikimit buxhetor në afat të shkurtër dhe të mesëm. Kjo nënkupton që është ende shumë herët të vlerësohet ndikimi i programit në kredibilitetin e buxheteve të cilat i referohen të dhënave aktuale nga zbatimi i buxhetit. Ky ndikim mund të vlerësohet më së paku në pranverën e vitit 2015, gjithmone duke u mbështetur në të dhënat reale nga zbatimi i buxhetit të vitit 2014.

2.2 Një vështrim mbi fushat e vlerësuara të projektit dhe indikatorët

2.2.1 Vërejtje te përgjithshme lidhur me situatën aktuale në qeverisjen lokale dhe dldp-në

Duke folur nga pikëpamja strategjike, përqasja që dldp-ja ka zgjedhur është tepër ambicioze dhe perfshirëse sepse prek shumë dimensione të fushës së menaxhimit të financave publike si:


- buxhetimin me orientim strategjik,
- kombinimin e planifikimit financiar me atë të planifikimit të politikave,
- planifikimin e detajuar afatmesëm,
- programimin gjithëpërshirës dhe
- menaxhimin e performances.

Duke patur parasysh kontekstin dhe stadin aktual të menaxhimit të financave publike në Shqipëri, ky trajtim është tepër sfidues, kështu që në mënyrë që të ndërtohet një frymë dhe mbështetje lokale, rritja e kapaciteteve si nga pikëpamja institucionale ashtu dhe ajo e njohurive ka rëndësi strategjike.

Ne terma të instrumenteve konkrete të menaxhimit të financave publike dhe strategjike, dldp-ja mbështeti zhvillimin dhe aplikimin e tre instrumenteve:

- planet strategjike të zhvillimit (PSZH),
- buxhetet afatmesme, duke përdorur klasifikimin e programeve me orientim nga performanca (PBA) dhe
- një instrument të planifikimit financiar (IPF),
- Në fund të vitit 2012, dldp vendosi të kompletojë listen e instrumenteve të mesipër me një tjetër produkt: paketën fiskale.

Futja e produktit të fundit u fut me synimin e kompletimit të bazës së planifikimit strategjik/buxhetor vjetor dhe afatmesëm për ta sjellë atë në përputhje me praktikën më të mirë të drejtimit të financave publike në nivel lokal siç tregohet në skemën e mëposhtme. Është për tu theksuar se futja e një instrumenti të tillë paraqet një sfidë në kontekstin e autonomisë fiskale të kufizuar të NJQV-ve siç shpjegohet në seksionin e mjedisit aktual të decentralizimit.



Skema e Nderveprimit midis Zhvillimit Strategjik dhe Planifikimit afatshkurter dhe afatmesëm Buxhetor.

Nga ana tjetër kjo levizje vjen në kohën e duhur sepse mjeti për ta përdorur në mënyrë efektive në programimin fiskal, me saktësi IPF, është aktualisht në përdorim dhe zyrtarët publikë lokalë janë trainuar tashmë për ta përdorur atë në mënyrë të krenarshme.

2.2.2 Lista e Indikatorëve, metodologjia e përdorur për vlerësimin dhe domethenia.

Në linjë me objektivin e ushtrimit dhe mandatin e konsulentit, vëmendja u përqendrua në dy fusha:

- se pari vlerësimin e metodologjisë, procesit dhe cilësive së paketave fiskale
- dhe më pas vlerësimin e konsistencës së paketës fiskale me pjesën tjetër të mbështetjes të programit d.m.th PSZH/PBA.

Per sa i perket fushes se pare, vleresimi eshte bere duke ne linje me kerkesat klasike te nje sistemi modern dhe fiskal taksimi dhe komponenteve te tij, te cilet jane radhitur me poshte:

- *Pajtueshmeria me kerkesat ligjore*
- *Besueshmeria*
- *Arritshmeria*
- *Barazia*
- *Transparenca dhe Pergjegjshmeria*
- *Pjesmarrja dhe Motivimi*

Per sa i perket fushes se dyte vleresimi, konsulenti u perpoq te vleresonte cilesine e paketes fiskale ne linje me kerkesen e *Sinergjise dhe Lidhshmerine*, qe gjithashtu rezultuan ne nje set indikatorësh te cilet shpjegohen me poshte.

Si pjese e te njejt vleresim dhe ne menyre qe te informohet procesi i monitorimit te programit ne linje me mandatin e tij, konsulenti beri nje vleresim *te tre indikatorëve te cilet masin domethenien e instrumentatve te mbështetur nga programi dldp per procesin e buxhetimit sipas politikave dhe besueshmerine e tij, perkatesisht Indikatore te Ndryshimit Globale ING 1, ING 2, ING 3*. Perderisa mandati kryesor i Dldp dhe ekspertiza kryesore e saj per NJQV-te lidhet kryesisht me keto kerkesa te sistemit te drejtimit te financave publike, keta tre indikatore u ndertuan me synimin per te vleresuar rezultatet e programit ne teresi ne lidhje me sistemin e drejtimit te financave publike; me fjale te tjera keta indikatore jane konsideruar si indikatore te ndryshimit global , te cilet matin rezultatet e dldp ne lidhje me te gjithë komponentet e mbështetjes qe kontribuojne ne kete sistem perkatesisht PSZH, PBA, dhe PF.

Kerkesat	Indikatoret
Pajtueshmeria me kerkesat ligjore	I1- Pershtatshmeria me kerkesat ligjore ne aprovimin e paketave fiskale dhe tipi i votimit
	I2- Jane dispozitat e paketes fiskale ne linje me kerkesat ligjore ne fushen e taksave lokale dhe tarifave?
Besueshmeria	I3- Ekzistenca e bazave te te dhenave te taksapaguesve
	I4- Perdorimi i Analizes Statistikore ne menyre qe te gjenden tendencat ne mbledhjen e taksave
Arritshmeria	I5- A jane konsideruar kapacitetet administrative kur jane future ose modifikuar niveli i taksave vendore dhe tarifave ?
Barazia	I6-A jane respektuar kerkesat e barazise vertikale dhe horizontale kur jane vendosur apo modifikuar nivelet e taksave dhe tarifave?
Transparenca dhe Pergjegjshmeria	I7- A ka informacion te disponueshem per tatimpaguesit ? Sa efektivisht jane perdorur kanalet e komunikimit te disponueshme?
Pjesmarrja dhe Motivimi	I8-Cili ka qene niveli i pjesmarrjes se paleve te interesuara ne procesin e pergatitjes se paketave fiskale?
	I9-A ka nje proces komunikimi efektive per te motivuar dhe promovuar pjesmarrjen?
Sinergjia dhe Lidhshmeria	I10- A eshte paketa fiskale konsistente me PBA –te ne terma te te ardhurave dhe shpenzimeve te parashikuara?
	I11- A jane supozimet e paketes fiskale ne linje me parashikimet makro-ekonomike ne nivel kombetar?
Buxhete te bazuara ne Politika	ING-1 Numri i projekteve strategjike ne buxhetin vjetor
	ING -2 Pjesa relative e buxheteve vjetore per projekte strategjike
Buxhete te Besueshme	ING -3 Devijimi total in buxheteve vjetore nga buxhetet e parashikuara ne PBA-te e nje viti me pare ne lidhje me shpenzimet.

Vleresimi u krye duke kombinuar studimin e materialeve dhe rezultatet e pergjigjeve te pyetesoreve qe iu shperndane NJQV-ve, objekt i veprimtarisë se programit ne Qarkun e Lezhës dhe Shkodrës. Nje kopje e pyetesorit mund te gjendet ne Aneksin 1.

Ne seksionet e mëtejshme, jepet nje shpjegim i detajuar per çdo indikator ne nivel NJQV-je, subjekt i mbështetjes së dldp ne fazen II duke u bazuar ne informacionin e disponueshem deri ne fund te 2013.

3 SHQYRTIMI I DETAJUAR DHE GJETJET KRYESORE

3.1 Shqyrtimi i Detajuar

3.1.1 Pershtatshmeria me kërkesat ligjore

Indikatoret nën këtë titull kanë si fokus bazën legale të dispozitave dhe komponenteve të paketës fiskale. Nëse këto janë në linjë me kërkesat ligjore ato janë të besueshme dhe kanë më tepër mundësi të zbatohen në atin e gjatë. Përveç kësaj, këta indikatore përpilojnë të nxjerrin në pah procesin nepermjet e cilit këto paketa fiskale fitojnë vlerat ligjore: nëse kjo bazë vjen nepermjet një procesi demokratik votimi, PF kanë më tepër gjasa të pranojnë dhe detyrimi për t'i zbatuar bëhet më efektiv.

Nga informacioni i paraqitur në Tabelën I1, mund të vërehet që PF janë miratuar me shumicë absolute edhe pse ligji kërkon një miratim me shumicë të thjeshtë. Veprimtaria e dldp në këtë drejtim duket se i ka bërë paketat fiskale me shumë gjasa detyruese që prej aprovimit për çdo lloj interesi politik në të ardhmen. Nga ana tjetër kjo arritje rrit besueshmerinë dhe sigurinë e paketave fiskale për të ardhmen pavarësisht ndryshimit të interesave të paleve pjesëmarrëse në proces.

E njëjta është e vërtetë jo vetëm për paketat fiskale në teresi por edhe për taksat dhe tarifën e parashikuar në to. Nga shqyrtimi i detajuar i këtyre dokumenteve kundrejt kërkesave ligjore në ligjet kombëtare, konsulenti arriti në përfundimin që dispozitat e PF janë në linjë me kërkesat e kuadrit ligjor në lidhje me kompetencat e NJQV-ve lidhur me nivelet maksimum të taksave, tarifave vendore, procedurat e pagimit, përpunimin e informacionit, penalitetet etj.

Duke patur parasysh gjithë këtë informacion, mund të dilej në përfundimin që programi dldp ka bërë një punë të shkëlqyer për të identifikuar kërkesat ligjore lidhur me dispozitat e paketave fiskale dhe përdorur ato në dobi të programit si pjesë e një produkti standart cilesor si PF brenda paketës së tij të mbështetjes. Dldp mund të vazhdojë t'i përmirsojë dhe t'i ndajë këto risi në shkallë kombëtare si qendër ekselence dhe ekspertizë në takime/konferenca kombëtare dhe rajonale si pjesë e kontributit të programit për të avancuar axhendën e decentralizimit në linjë me praktikën më të mirë dhe historitë e sukseseve të arritura.

Tabela I1: Konformiteti me Rregullat Ligjore për PF

NJQV	Kërkesa ligjore për aprovimin e paketës fiskale	Tipi i kërkuar i Votimit	Votimi Aktual
Bushati	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Dajç Bregu i Bunës	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Kallmeti	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Lezha	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Puka	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Rubiku	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Vau i Dejes	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute
Velipoja	Po	Shumicë e thjeshtë	Shumicë absolute

Tabela I2: Kërkesat ligjore të respektuara për Taksa Tarifa

NJQV	A janë dispozitat e Paketës Fiskale në linjë me kërkesat ligjore në fushën e taksave dhe tarifave
Bushati	Po
Dajç Bregu i Bunës	Po
Kallmeti	Po
Lezha	Po
Puka	Po
Rubiku	Po
Vau i Dejes	Po
Velipoja	Po

Burimi: Studimi Paketave Fiskale individuale të NJQV-ve dhe krahasimi me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e NJQV-ve në këtë fushë.

3.1.2 Besueshmeria

Indikatoret I3 dhe I4 masin besueshmerinë e paketave fiskale dhe niveleve të taksave dhe tarifave. Në teori, një nivel takse apo tarife është më i besueshëm kur informacioni që informon procesin e vendimarrjes rreth tij është realist dhe i vlerësuar në mënyrë të arsyeshme. Disponueshmeria e të

dhenave potenciale ne formen e regjistrave te taksapaguesve, aktiviteve, te pronave etj mbi te cilat vilet taksa apo tarifa eshte pra thelbesore. Po kaq e rendesishme eshte dhe aftesia e zyrtareve publike per te perdorur metoda analize statistikore per te analizuar keto te dhena. Indikatoret e zgjedhur me poshte ndjekin kete logjike ne menyre qe te diktohet disponueshmeria e ketij informacioni, se sa domethenes eshte ai per te informuar procesin e pergatitjes se paketes fiskale dhe po ashtu perdorimin e metodave statistikore per te vleresuar nivele te arsyeshme te taksave/tarifave qe kane mundesine per te rritur te ardhurat fiskale ne te ardhmen.

Tabela e indikatorit I3 tregon qe ekzistenca e regjistrave te taksapaguesve konfirmohet ne 7 nga 9 NJQV. Te tjeret nuk e kane konfirmuar ne trajten e te dhenave zyrtare qe formon nje "baze te dhenash" ne vetvete, kurse te dhena te thjeshta jane te disponueshme gjithandej per arsyen e thjeshte se qe prej vitit 2008, NJQV-te kane qene pergjegjese per mbledhjen e TBV. Ekzistenca e regjistrimeve per te tjera taksa (si ne Lezhe, Dajç dhe Puke) perpara kesaj kohe ka te beje me se shumti me te tjera taksa dhe taksa dhe tarifa si ato per pronen, hapësirën e gjelber, tarifat per liqensat etj.

Tabela I3: A ka nje baze te dhenash per tatimpaguesit dhe prej sa vitesh?

NJQV	Ekzistenca e Bazes se te dhenave	Vitet
Bushati	Po	4
Dajç Bregu i Bunes	Po	7
Kallmeti	Po	2
Lezha	Po	8
Puka	Po	7
Rubiku	na	na
Vau i Dejes	na	na
Velipoja	Po	3

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV-te

Nga sa me siper mund te shihet qe vetem tre prej tyre kane nje nivel te dhenash qe krijon nje baze te arsyeshme¹ per perdorimin e metodave statistikore; si rrjedhoje krijimi dhe pasurimi i regjistrave te taksave me te dhena te nevojshme per kalkulimin e niveleve efektive te taksave mbi burimet kryesore te te ardhurave ne nivel lokal pervec TBV eshte nje prioritet. Nenkuptohtet qe eshte urgjente identifikimi, shkembimi i informacionit me autoritetet rajonale dhe kombetare ne menyre qe te transferohen te dhenat nga regjistrat kombetare (regjistri civil, kadastres, i rrugeve dhe pronesive). Dldp mund te lehtesoje brenda mandatit te saj kete proces te shkembimit te te dhenave, duke perdorur procesin reformes territoriale dhe administrative si nje mundesi per te rritur vetedijen e autoriteteve publike ne rendesine e te dakortesise midis niveleve te ndryshme te qeverise dhe veprimin konkret per t'iu pergjigjur nevojave te NJQV-ve ne kete drejtim ne pajtim me pergjegjesite e tyre ligjore².

Tabela I4 eshte populluar me informacion cilesor dhe sasior qe i referohet nivelit aktual te perdorimit te te dhenave te disponueshme per analiza statistikore, modalitetet dhe perceptimin e NJQV-ve per procesin e nje analize te tille³.

Megjithse, disponueshmeria e te dhenave lejon perdorimin e analizave statistikore te thjeshta ne tre NJQV, ato perdoren vetem ne nje (Dajç Bregu i Bunes), kurse perdorimi ne nje tjeter NJQV (Kallmeti) behet me te dhena te pamjaftueshme. Megjithate nga kontrolli i i paketave fiskale dhe pergjigjet e pyetesorit, duket sikur tendenca e pergjithshme eshte thjesht ekstrapolimi i normave aktuale te mbledhjes

¹ Per parashikimet e thjeshta statistikore si ato progresive, duhen te pakten 5 vjet te dhena per te patur nje siguri te mjaftueshme ne ekstrapolimin apo korigjimin e tendencave aktuale te variablave ne linje me faktoret qe ndikojne si demografia apo faktoret sezonale.

² Ne fakt, qeveria qendrore eshte e detyruar nga ligje te ndryshme (Ligji mbi Lirine e Informacionit, Karta Europiane e Qeverisjes Vendore e ratifikuar nga Shqiperia, Ligji Organik i Buxhetit, Ligjet mbi Qeverisjen Vendore, Ligji mbi Statistikat etj) te ndaje nese i kerkohet te dhanat dhe regjistrimet me qeverisjen vendore sidomos mbi popullsine, rruget, pronat, investimet dhe subvencionimet.

³ Ky nivel perceptimi bazohet ne pergjigjet e NJQV-ve nje pyetesori qe adresoi nje pyetje te mbyllur mbi kete ceshtje per tu pergjigjur d.m.th NJQV-te u pyeten per tu pergjigjur nese ato e konsideronin perdorimin aktual te te dhenave per analize statistikore te varfer, te pamjaftueshme, te mjaftueshme apo te mire.

se taksave ne te ardhmen mbi bazen e supozimeve te thjeshta dhe subjektive ne vend te supozimeve te te ndertuara mbi bazen e analizave statistikore.

Tabela 14: A perdorin NJQV baza te dhenash per taksat/tarifate? Cili eshte niveli i kenaqsisë se tyre per kete?

NJQV	Ekzistenca e Bazes se te dhenave	Vitet	Analize statistikore per te gjetur tendencen ne mbledhjen e taksave	Vetevleresim per nivelin e perdorimit te analizës statistikore
Bushati	Po	4	Jo	n.a
Dajç Bregu i Bunes	Po	7	Po	Mjaftueshem
Kallmeti	Po	2	Po	Mjaftueshem
Lezha	Po	8	Jo	Mjaftueshem
Puka	Po	7	Jo	n.a
Rubiku	na	na	na	n.a
Vau i Dejes	na	na	na	n.a
Velipoja	Po	3	Jo	I mire

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV dhe studim i Paketave Fiskale nga NJQV e asistuar

Kuadrati 1: Perdorimi i Pamjaftueshem i analizave statistikore ne mjedisin e drejtimit te financave publike ne Shqiperi ne nivel qendror.

Perdorimi i pamjaftueshem dhe joefektiv i metodave/dhenave statistikore per te gjeneruar parashikime te besueshme eshte nje problem serioz jo vetem per qeverisjen vendore por edhe ate qendrore. Rezultatet e fundit te PEFA per Shqiperine kane treguar qe parashikimet teper optimiste gjate periudhes 2009-2011 kane çuar ne planifikime te ardhurash/shpenzimesh jorealiste te cilat jane rishikuar te pakten nje here per çdo vit buxhetor gjate kesaj periudhe, duke rezultuar keshtu ne shkurtime buxhetore, te cilat kane minuar besueshmerine e buxhetit. Kjo sjellje ka qene identifikuar dhe prej donatoreve internacionale si (FMN, BB, BERZH) te cilet ne menyre te vazhdueshme kane rishikuar shifrat e raportuara shqiptare me parashikime shume me konservative. E njejta eshte e vertete po ashtu per analizen e impaktit te politikave per programe kryesore publike or per ndryshime politikash e cila eshte bere mbi supozime *ad hoc* nga zyrtaret publike me teper se mbi bazen e analizave statistikore te dhe vleresimeve te variblave ne diskutim.

Rastet e raportuara te mos-shfrytezimit te mundesise per analiza te mira statistikore nga ana e NJQV-ve atje ku ka te dhena te mjaftueshme tregon per mungese kapacitetesh apo mjetesh te nevojshme per ta realizuar. Çfare eshte me e rendesishme eshte se ka nje perceptim te pergjithshem se kjo menyre “e te berit te gjerave” eshte e mjaftueshme per nevojat e NJQV-ve ne procesin e pergatitjes se paketave fiskale, gje e cila mund te çojë ne nivele te papershtatshme te taksave/tarifave, dhe per rrjedhoje ne parashikime te gabuara te te ardhurave.

Dldp duhet te jete e kujdesshme ketu dhe te mbikqyre po ashtu menyren ne te cilen zyrtaret perdorin IPF per programimin fiskal: ka mundesi qe zyrtaret publike preferojne te vendosin nivelin e taksave/tarifave duke filluar nga ajo çfare nevojitet ne terma te burimeve me teper se ajo qe eshte e arritshme duke u nisur nga regjistrimet e taksave/tarifave, duke çuar keshtu ne keqperceptime te realitetit dhe te te ardhurave potenciale ne te ardhmen.

Duke u nisur nga gjithëçka u tha me siper ka vend per te rritur vetedijen e zyrtareve publike mbi perfitimet nga analizave te thelluara statistikore si nje menyre per te rritur realizimin e projeksioneve te te ardhurave/taksave; dldp ka eksperiencen dhe influencen e duhur per te qene efektive ne kete drejtim. Nje tjetër drejtim i veprimit ne te ardhmen do te ishte permirsime i kapaciteteve te NJQV-ve ne te ardhmen nepermjet trainimeve dhe instruktimit ne perdorimin e analizave te tilla per te derivuar nivele te ardhshme te taksave/tarifave lokale.

3.1.3 Arritshmeria

Indikatori I5 merret me arritshmerine e paketave fiskale ne terma te resurseve administrative, ketu te llogaritur si zyrtare publike te disponueshem dhe menyren se si NJQV-te kane vepruar gjate periudhes se implementimi te dldp kur jane ndryshuar numri dhe nivelet e taksave apo tarifave.

Tabela I5: A eshte konsideruar çeshtja e kapaciteteve administrative kur jane futur ose modifikuar niveli i taksave/tarifave? Ne çfare menyre i kane perdorur NJQV burimet ne dispozicion?

NJQV	Ngarkesa e punes e zyrtareve tatimore					Ndryshimi ne Ngarkese/Eficiçensa				Si jane trajtuar kapacitetet administrative?
	2010	2011	2012	2013	2014	2011	2012	2013	2014	
Bushati	4.0	3.0	3.0	2.8	2.8	-25%	0%	-7%	0%	Asnje konsiderate
Dajç Bregu i Bunes	11.0	11.0	11.0	11.0	11.0	0%	0%	0%	0%	Perdorim Ekstensiv i Res
Kallmeti	3.0	3.0	4.7	5.0	4.0	0%	56%	7%	-20%	Perdorim Eficient i Res
Lezha	3.6	3.6	3.6	3.6	3.0	0%	0%	0%	-17%	Perdorim Ekstensiv i Res
Puka	15.0	15.0	7.5	7.5	7.0	0%	-50%	0%	-7%	Perdorim Ekstensiv i Res
Rubiku	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a
Vau i Dejes	4.5	3.4	3.4	3.8	3.8	-24%	0%	12%	0%	Perdorim Eficient i Res
Velipoja	1.5	2.2	2.0	2.4	2.6	44%	-8%	19%	11%	Perdorim Eficient i Res

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Gjate mbledhjes se te dhenave per te vleresuar kete indikator u verejt qe ka nje tendence per te rritur numrin e tarifave me teper se te taksave¹, i cili tregon nje tendence te NJQV-ve per te perdorur tarifat per sigurimin e sherbimeve si nje menyre per te rritur te ardhurat. Kjo strategji eshte ne linje me me pushtetin dhe autonome e dhene autoriteteve vendore nga ligji², dhe per me teper eshte dhe nje menyre efektive per te rritur te ardhurat lokale sepse tarifa merret ne shkembim te nje sherbimi konkret i cili u jepet individeve, d.m.th perfitimi i qytetarit eshte me i lehte per tu identifikuar dhe kostuar.

Nga tabela e mesiperme mund te shihet se ngarkesa e punes e zyrtareve publike tatimor mbetet e larte dhe per ta perballuar ate shumica e NJQV-ve (60%) kane rritur numrin e zyrtareve publike. Megjithate vihen re dhe NJQV (Kallmet, Vau i Dejes, Velipoja) te cilat jane perpjekur te rrisin eficiçensen e punes te zyrtareve tatimore duke investuar ne programe kompjuterike, kembim informacioni me zyrtar rajonale te taksave etj. Duke u nisur nga kjo atehere nuk duket te jete surprize qe po keto njesi vendore kane dhe rezultate me te mira ne devijimin midis niveleve te PBA-ve dhe atyre te Buxheteve Vjetore (ING3). Dldp duket se ka patur nje rol te rendesishem ketu me trainimet dhe mjetin e Planifikimit Financiar te cilat e kane bere me te dukshem lidhjen e ngushte midis planifikimit strategjik, PBA-se dhe FP-se.

Duke patur parasysh kete informacion dhe ne kontekstin e rritjes ekonomike te dobet te shoqeruar me shtrengesa buxheti, NJQV-te duhet te synojne te rrisin me teper eficiçensen e punes sesa numrin e zyrtareve publike; keshtu qe puna e dldp per te mbeshtetur trainimin e zyrtareve tatimore si nje menyre per te rritur eficiçensen e perdorimit te burimeve administrative dhe njerezore eshte shume e rendesishme. Nenkuptohet qe eshte e nevojshme qe dldp te vazhdoje me te mbeshtese produktin e paketes fiskale dhe te lidhjes se saj me PSZH/PBA-te nepermjet IPF. Me te njeten kohe, dldp mund te perdore kete informacion per te informuar procesin e reformes se re administrative dhe territoriale ne menyre qe te gjykohet mbi kostot/perfitimet e alternativave ne dobi te zgjedhjes se me te mires se mundshme.

¹ Ne menyre qe te kuantifikohej kapaciteti administrative ne NJQV-te, konsulenti mati fillimisht dhe per çdo vit te periudhesh 2010-2014, ngarkesen e punes te zyrtareve vendore publike per taksat/tarifat si vijon : Ngarkesa e punes= (Nr i Taksave+Nr e Tarifave)/Nr e Zyrtareve Pergjegjes. Te dhenat u morren nga pergjigjet e pyetesoreve te shperndara NJQV-ve per çdo komponent te formules se llogaritjes se ngarkeses se punes. Pastaj ndryshimi ne ngarkesen e punes u llogarit ne menyre qe te nxirrej nje perfundim per ate se si NJQV-te kishin konsideruar kapacitetet administrative kur kishin ndryshuar (rritur) numrin e taksave/tarifave. Ne ato raste kur ishte shtuar numri i taksave dhe tarifave duke rritur numrin e zyrtareve publike pergjegjes per to, ngarkesa e punes mbetet konstante ose dhe pakesohet. Ne te kunderten kur ngarkesa e punes rritej ne kohe, NJQV-te kishin zgjedhur si rruge per tu perballur me çeshtjen e kapaciteteve administrative ate te rritjes se eficiçenses. Per kete te fundit konsulenti u kerkoi korrespondenteve te citonin masat me te rendesishme qe NJQV-te kishin perdorur per te rritur eficiçensen e punes te zyrtareve tatimore lokale.

² Duke iu referuar kuadrit ligjor shqiptar, nivelet e tarifave dhe procedurat e mbledhjes se tyre ne nivelin vendore jane krejtesisht kopetence e autoriteteve vendore.

3.1.4 Barazia

Indikatoret ketu masin nese ka ndonje konsiderate per barazine qofte ajo horizontale, d.m.th te gjithë qytetaret perballen me te njejtin nivel takse/tarife, dhe/ose barazine vertikale, d.m.th taksat/tarifat merren mbi bazen e parimit te aftësisë per te paguar. Eshte nje indikator i cili perpiqet te vlerësoje siç e meriton barazine horizontale dhe vertikale, te cilat gjithmone kane ecur krah per krah ne diskutimet ekonomike/politike.

Tabela I6: A vihet re barazi horizontale dhe vertikale?

NJQV	Ekzistenca e Barazise Horizontale ne Taksa dhe Tarifa	Ekzistenca e Barazise Vertikale ne Taksa dhe Tarifa	Barazia Vertikale ne te ardhurat totale
Bushati	Po	Po	11.70%
Dajç Bregu i Bunes	Po	Po	33.70%
Kallmeti	Po	Po	n.a
Lezha	Po	Po	21.10%
Puka	Po	Po	n.a
Rubiku	Po	Po	n.a
Vau i Dejes	Po	Po	n.a
Velipoja	Po	Po	18%

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Te dhenat nga indikatorët tregojne qe konsideratat e barazise horizontale jane prezente ne te gjithat taksat dhe tarifat. Ky realitet ka te beje me politiken e pergjithshme fiskale te takses se sheshte mbi te ardhurat direkte ne periudhen 2008-2013. Barazia vertikale eshte e pranishme po ashtu, megjithate ne me pak se 30% te totalit te planifikuar te te ardhurave¹. Kategorite e qytetareve te cilet perfitojne nga perjashtimet nga detyrimi per te paguar taksa/tarifa jane kryesisht personat me aftësi te kufizuar, personat me ndihme sociale, te moshuarit dhe te papunet. Gjithesesi nuk ka nje konsiderate te veçante nese eshte me perfitim te perjashtohen kategorite e mesiperme ne lidhje me taksat, tarifat apo te dyja.

Persa i perket ketij indikator, eshte e qarte se dldp nuk ka mandat per te hyre ne diskutime politike qe kane te bejne me barazine vertikale apo horizontale te taksave/tarifave. Megjithate ka vend per kontribut te programit ne lidhje me te dhenat dhe argumente praktike ne menyre qe te shmangët retorika e panevojshme politike. Per te arritur ketu, dldp duhet te vazhdoje me aktivitetet e ndertimit te kapaciteteve ne lidhje me perdorimin e IPF i cili se bashku me PF mund te ofroje skenare te ndryshem nen presupozime te ndryshme, te cilat perfshijne dhe konsideratat vertikale dhe horizontale ne propozimet fiskale.

3.1.5 Transparenca dhe Pergjegjshmeria

Indikator i meposhtem mundohet te rroke nese ke informacion te mjaftueshem per qytetaret ne lidhje me taksat/tarifat² per t'i lejuar ata qe te dine dhe te planifikojne ne avance per te paguar nje nivel te caktuar te takses apo tarifës. Kjo konsiderate eshte e rendesishme sepse ka shume vendime individuale/biznesi qe varen nga ajo se sa e sigurte eshte nje nivel i caktuar i takses/tarifës qe aplikohen ne aktivitetet te ndryshme ekonomike.

Nga te dhenat ne te tabelen e majte, mund te shihet that informacioni per taksa/tarifa me instruksione te qarta me afatet dhe penalitetet ne rast mospagese eshte i disponueshem ne me pak se 50% te NJQV-ve;

¹ Kolona e fundit ne table i korrespondon peshës specifike te taksave/tarifave te cilat pershkruajne perjashtime nga detyrimi per te paguar, mbi bazen e aftësisë per te paguar, mbi totalin e te ardhurave te planifikuara. Nje perqindje e tille eshte kalkuluar bazuar ne informacionin e mbledhur nga pergjigjet e pyetesoreve dhe po ashtu nga shqyrtimi i dokumentave te paketave fiskale

² Ne pyetesorin adresuar NJQV, u pyet se per sa taksa/tarifa informacioni u ish dhene ne avance tatimpaguesve per detyrimin per te paguar, afatin, penalitetet ne rast mospagese etj. Numri i taksave/tarifave me kete lloj informacion u shpreh ne perqindje te numrit total te taksave/tarifave ne menyre qe te plotesohej tabela e mesiperme ne te majte gje qe bente te mundur krahasimin midis NJQV-ve

Tabela I7: A është i disponueshem informacioni per taksat dhe tarifat per tatimpaguesit? Sa efektivisht jane perdorur kanalet e komunikimit¹?

NJQV	Disponueshmeria e Inf per Taksat				Disponueshmeria e Inf per Tarifat				NJQV	Kanalet e Komunikimit	Përqindja	Rangu
	2010	2011	2012	2013	2010	2011	2012	2013				
Bushati	100%	100%	100%	100%	40%	40%	40%	29%	Bushati	4 nga 5	80%	B
Dajç Bregu i Bunes	14%	14%	14%	14%	0%	25%	25%	25%	Dajç Bregu i Bunes	4 nga 5	80.0%	A
Kallmeti	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	Kallmeti	3 nga 5	60%	B
Lezha	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	Lezha	3 nga 5	60%	B
Puka	30%	30%	30%	30%	40%	40%	40%	40%	Puka	5 nga 5	100%	n.a
Rubiku	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	Rubiku	n.a	n.a	n.a
Vau i Dejes	33%	38%	38%	38%	33%	33%	33%	27%	Vau i Dejes	2 nga 5	40.0%	C
Velipoja	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	Velipoja	4 nga 5	80%	A
Ne total	60%	60%	60%	60%	52%	55%	55%	53%	Ne total		71%	A

Burimi: Përgjigjet e pyetesoreve nga NJQV

kjo gje qe tregon per nje nivel te pakenaqshem te informacionit ndaj taksapaguesve. Ka po ashtu nje nivel me te ulet informacioni per tarifat krahasuar me taksat, i cili mund te ndikojte negativisht ne pagesen e detyrimeve dhe ne te ardhurat totale duke patur parasysh tendencen e rritjes se tarifave ne NJQV-te (siç u shpjegua e vleresimin e I5).

Duke iu referuar perdorimit te kanaleve te komunikimit, duket se ato jane ende jo-efektive per te mbuluar te gjithat taksat dhe tarifat. Mjetet me te zakonshme te perdorura te informimit ne komunikim eshte informacionin i shtypur ne formen e pageses/kalkulimit te taksave/tarifave dhe ai i postuar ne tabelat e komunikimit te NJQV-ve, te cilat se bashku kane nje mundesi te kufizuar per te arritur numrin maksimum te qytetareve². Fletpalosjet, fushatat informuese, mediat te cilat mund te shenjestronin tatimpaguesit potenciale te ardhshem nuk kane qene perdorur fare ne 50% te NJQV-ve te diskutuara ketu.

2013 eshte viti i pare qe dldp mbështet komponentin e PF dhe vleresimi i indikatorëve tregon qartesisht qe ka vend per permirsim sidomos kur kihet parasysh ecuria e mire e programit ne komponente te tjere. Ky permirsim do te rrise transparencen dhe parashikueshmerine e taksave/tarifave, te cilat pastaj do te influencojne zbatimine PF ne NJQV-te e mbështetura. Dldp ka mundesine te bashkrendoje stimujt e NJQV-ve per te punuar ne kete drejtim nepermjet perhapjes se praktikave te mira te zhvilluara ne komponente te tjere te programit, te cilat kane te bejne me kanale novatore te komunikimit qe kane mundesine e te arriturit te nje numri sa me te madh qytetaresh.

3.1.6 Pjesmarrja dhe Motivimi

Indikatori I8 rrok pjesmarrjen e paleve te interesuara ne procesin e pergatitjes se paketes fiskale. Nje pjesmarrje e larte eshte gjithmone objektivi per tu arritur sepse nenkupton qe produkti i paketes fiskale ka me teper shanse qe te zbatohet me sukses dhe te rritet mbledhja e te ardhurave.

Informacioni i paraqitur ne kete table tregon qe ka nje pjesmarrje nga mesatare ne te mire te paleve te interesuara ne proces. Eshte nje element i rendesishem, te cilit, pavarësisht se mbështetja e produktit te paketes fiskale eshte ne hapat e para, duhet t'i kushtohet vemendje sepse ne te kunderten mund te sjelle si pasoje nivele me te uleta te pageses se detyrimeve dhe rendimentit te taksave/tarifave. Si nje tendence e pergjithshme palet pjesemarrëse qe jane me aktivisht te perfshira ne procesin e pergatitjes se PF jane entitetet ekonomike, shoqatat dhe rinia- kjo tregon qe procesi i pergatitjes se paketes fiskale eshte te pakten i besueshem per pjesen me aktive dhe dinamike te komunitetit te qytetareve. Ata qe nuk jane pothuajse asnjehere jane autoritetet rajonale, gje qe tregon nivelin e ulet te kordinimit midis niveleve te ndryshme te qeverisjes.

¹ Respondents were asked to provide answers on what from a typical range of tools/channels of communication were used for informing citizens on taxes and charges being applied within confines of their LGUs.

² Shenjestra e tyre kryesore jane vetem tatimpaguesit *aktuale* ose tatimpaguesit te cilet kane nje kontakt pak a shume te rregullt me administraten e NJQV-se.

Tabela I8: Cili ka qene niveli i pjesmarrjes se paleve te interesuara ne procesin e pergatitjes se paketes fiskale?

NJQV	Pjesmarrja e paleve te interesuara ne proces	Perqindja	Rangu
Bushati	12 nga 15	80%	A
Dajç Bregu i Bunes	7 nga 15	53%	C
Kallmeti	3 nga 14	21%	D
Lezha	5 nga 14	36%	C
Puka	11 nga 15	73%	B
Rubiku	na	na	na
Vau i Dejes	5 nga 14	35%	D
Velipoja	10 nga 14	71%	A
Ne total		53%	B

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Duke patur parasysh sa u tha me siper, eshte e nevojshme te diagnostikohet dhe analizohet procesi i komunikimit dhe kanalet e tij per te identifikuar ato qe jane me efektive ne konktestin/mjedisin respektiv te NJQV-ve. Nje sugjerim tjetër qe mund te behet ketu eshte kerkimi i rrugeve novatore per te projektuar aktivitetet e programit dhe stimujt ne menyre qe te shtyhen NJQV-te te rrisin numrin e pjesmarresve ne proces dhe sinergjine me aktivitetet e komponenteve te tjere (PSZH/PBA) ne menyre qe te garantohet efektiviteti i perpjekjeve.

Indikatori tjetër I9 mat informacionin perkates per nje nga elementet qe pritët te nxise permirsimin, me konkretisht : kanalet e komunikimit. Ai fokusohet ne kanalet qe ekzistojne deri me tani dhe sa efektive jane ato per te arritur numrin me te madh te mundshem te paleve te interesuara.

Tabela I9: A ka nje proces efektiv komunikimi per te promovuar dhe motivuar pjesmarrjen?

NJQV	Proçesi i Komunikimit per te promovuar pjesmarrjen	Kanalet e Komunikimit	Efekti ne pjesmarrje
Bushati	Po	5	A
Dajç Bregu i Bunes	Po	3	C
Kallmeti	Po	1	D
Lezha	Po	2	C
Puka	Po	4	B
Rubiku	na	na	na
Vau i Dejes	Po	2	C
Velipoja	Po	3	A
Ne total		3	C

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Nga te dhenat mund te vihet re ekzistenca e kanaleve te komunikimit te perdorura efektivisht ne dy NJQV (Bushati dhe Velipoja), gje e mire per programin i cil mbeshtet kete komponent vetem prej nje viti. Megjithate kanalet e zgjedhura te komunikimit¹ ne mesatare duket se nuk jane efektive per te arritur numrin me te madh te paleve te interesuara. Eshte e nevojshme qe programi t'i kushtojë vemendje ketij elementi sepse eshte kritik per te siguruar qe cilesine e paketes fiskale dhe zbatueshmerine e saj. Ka vend per te perfutur nga shembujt e mire te praktikave me te mira te zhvilluara ne te gjithe programin dhe madje dhe ne komponentin e PF siç tregohet ne kuadratin e meposhtem

¹ Ato kane qene kryesisht: takime dhe konferenca, artikuj ne media dhe publikime, fletepalosje, seanca degjimore me publikun dhe dokumente te shtypura.

Kuadrati 2: Përdorimi i mjeteve efektive tradicionale të komunikimit në një mjedis lokal plot sfida për të nxitur pjesëmarrjen e paleve të interesuara në proces.

